

VITI XIV, NUMRI 2 / SHKURT 2010

FOREVER



HUNGARY | ALBANIA | BOSNIA AND HERZEGOVINA | CROATIA | MONTENEGRO | SERBIA | SLOVENIA

PRESIDENT'S CLUB
2010

TOP 5
DISTRIBUTORS
2009

CONQUISTADOR CLUB
2009



Nga dritarja e pastër

Të gjithë e kanë dëgjuar shprehjen: „Koha nuk pret asnjëri”. Në rastin tim kjo ka qenë gjithmonë e vërtetë. S’më kujtohet që koha të ketë qenë ndonjëherë e mjaftueshme për mua. Kështu ishte edhe në moshën e fëmijërisë kur dëshiroja që të mos vinte aq shpejt darka. Ose sot kur dëshiroj të kaloj më shumë kohë me distributorët e mi. Por kështu mund të jetë edhe për ty kudo të jesh në botë. Jam i sigurt që edhe ti do të doje që koha të mos kalonte aq shpejt. Me përjashtim kur je pesë vjeç dhe po afrohen krishtlindjet, dhe mezi pret të vijë Plaku i Vitit të Ri.

Këtu në Amerikë, ashtu si edhe në vende të tjera, shkurti është muaji kur festojmë dashurinë. Ne këtë e quajmë dita e Valentinit. Në këtë periudhë u japim lule, kartolina, çokollata njerëzve që duam. I falenderojmë ata për faktin që janë pjesë e rëndësishme e jetës sonë. Vlerësimi i asaj që kemi është baza e shijimit të jetës. Kjo nevojitet edhe për t’u bërë të suksesshëm në FOREVER. Asnjëherë s’do të bëhesh i lumtur apo i suksesshëm nëse nuk e vlerëson atë që ke.

Njoh miliarderë të trishtuar. Cili është shkak i trishtimit të tyre? – mund të pyesësh. Për fat të keq nuk janë në gjendje të vlerësojnë dhe të çmojnë fitoret e arritura dhe njerëzit që i ndihmuan në rrugën që i çuan drejt atyre. Jetojnë për të nesërmen dhe harrojnë të vlerësojnë të sotmen. Ky parim është i vërtetë edhe në rastin e biznesit tënd. Jepi kohë vetes të zbulosh marrëdhëniet personale me anëtarët e skuadrës tënde. Këto duhet të bazohen tek besimi dhe vlerësimi. Edhe „shpirti më i fortë tregëtar” zbutet nëse i shpresh falenderim dhe i tregon mirëkuptim. Kjo është e rëndësishme sidomos në periudhën kulminante.

Është tipike që kur krijojmë marrëdhënie me njerëz të cilët kanë nevojë për FOREVER-in si mundësi biznesi – ose edhe vetëm për produktet – fillojmë një bisedë të cilën e quajmë bisedë 1/1. Kjo mund të ndodh në shtëpi ose në autobus, por me thënë të drejtën s’ka aspak rëndësi se ku jemi. E rëndësishme është që në këtë moment bëjmë përpjekje të vetëdijshme. Vendosim në radhë ato që duhet të themi në bazë të asaj që dëshiron të dëgjoj personi në fjalë. Kjo s’është e lehtë. Nevojitet një disiplinë e rreptë që t’i nënshtrohem gjërave të tjera duke ndryshuar programin tonë të ditës. Disa prej jush tani thoni: kjo s’është e vështirë, është e lehtë të dëgjosh. Të bëjmë një provë. Vini re momentin kur dy njerëz bisedojnë. Vini re se askush prej tyre nuk komunikon, por të dy mezi presin të marrin fjalën e të thonë atë që dëshirojnë. Kur bisedon me dikë, provo të bësh vetëm pyetje që kanë të bëjnë me tjetrin. Si je? Si e ke familjen? Si të shkon puna? Mos thuaj asgjë rreth vetvetes gjatë gjithë bisedës. S’është e lehtë, më beso. Por komunikuesit më të mirë e mësojnë se kështu duhet bërë. Dinë të dëgjojnë në mënyrë mjeshtërore dhe të bëjnë pyetje plotësuese ndërkohë që reagojnë ndaj pyetjeve. Dhe është e pabesueshme ajo që mund të arrijnë me këtë dituri.

Historia e mëposhtme më pëlqen shumë, më kujton se si të çlirohemi nga zakonet e përditshme personale.

Një çift i ri që ndodhet në lulëzimin e jetës shpërngulet në një zonë të pasur. Një mëngjes duke ngrënë, gruaja hedh sytë nga dritarja shikon një zonjë të moshuar e cila por nder rrobat e lara. „Këto rroba nuk duken shumë të pastra. Me sa shoh nuk di si duhen larë, ose ndoshta duhet të blejë një ilaç rrobash më të mirë” – i thotë gruaja burrit të saj. Burri shikon jashtë dhe nuk thotë asgjë. E njëjta bisedë zhvillohet gjithmonë mes tyre në çdo rast kur komshija nder rroba: gruaja e re hedh gjithmonë ndonjë fjalë përulëse dhe djegëse. Një muaj më pas çuditet kur shikon se sa të pastra janë rrobat e zonjës së moshuar. „Shiko, mësoi të laj. Më në fund bleu një ilaç rrobash të mirë” – i thotë burrit. Më në fund burri përgjigjet dhe thotë: „sot u ngrita më herët dhe pastrova dritaren!” Kështu ndodh edhe në jetën tonë. Ajo që shikojmë dhe dëgjojmë nga tjetri varet nga sa dritare e pastër e shikojmë atë.

Të uroj fat që kur të punosh të bëhesh dëgjues i mirë. Mos harro t’i kushtosh kohë faktit që njerëzit e veçantë ta ndajmë atë që përbëjnë për ty.

Me dashuri:

REX MAUGHAN, CEO





NJË FILLIM I SHKËLQYER

Jo çdo ditë na jepet mundësia të takohemi në vendin tonë me ndonjë nga drejtuesit më të mëdhenj të firmës sonë. Viti 2010 edhe në këtë aspekt nisi mirë, pasi në 22 janar në Budapest, kurse në 23 janar në Beograd u takuam me Aidan O'Hare, një nga drejtuesit e Forever Living Products Intl. Ishim tremijë vetë që dëgjuam me gojë hapur historitë e tij mësimdhënëse në të cilat theksoi rëndësinë e ndryshimit. Shpresoj se shumë prej nesh do t'i kenë parasysh edhe në të ardhmen.

Zakoni është gjë e madhe. Shumë prej nesh kanë frikë nga ndryshimi, ndërkohë që ndryshimi është vetë jeta. Në tokat e djerra hungareze emri tjetër i bukës është: jetë. Dhe buka përgatitet nga gruri i cili krijohet nga një farë e vogël – mundësia që fshihet tek kjo farë realizohet nga ndryshimi. Por në mënyrë që ndryshimi të përbëjë një mundësi të vërtetë duhet të kemi të qartë të kaluarën dhe vlerat tona. Në vendet tona ka shumë nevojë për krenari kombëtare, e cila nuk është shmangëse, por pranuese, nuk kthen shpinën, por ndihmon, bazohet në mirëkuptimin dhe dashurinë. Prej Aidan-it dëgjuam që dashuria s'është gjë tjetër veçse KOHA që kalojmë me të dashurit tanë, dhe Forever për këtë na ofron një mjet të shkëlqyer. Produktet fantastike, plani marketing që e tregon vetveten vazhdimisht prej tridhjetë vitesh dhe lëndët tona mësimore të mrekullueshme, të gjitha shërbejnë këtë qëllim.

Shkurti përveç fillimit të sezonit të ballos, bën fjalë edhe rreth mrekullisë së ditës së Valentinit. Rreth mrekullisë e cila ushqehet nga koha e kaluar së bashku në dashuri. Bashkëshortes sonë i japim dhuratat dhe i sigurojmë mundësinë që të paktën në këtë ditë gjithçka të bëjë fjalë rreth saj. Tek ne mund të gjeni çdo mjet që ta bëni të përsosur këtë ditë. Ju presin produktet e kategorisë së lartë, masazhatorët dhe mjeshtrat tanë të kozmetikës! Shfrytëzoheni këtë mundësi! Duajeni vetveten, duajini anëtarët e familjes, kolegët tuaj, Forever!

Me forcën e dashurisë do të bëhemi të parët! Përpara FLP Hungari!

DR. SANDOR MILESZ
DREJTOR GJENERAL

FOREVER 2010/02





Kronika e një *Dite Suksesi* festive

Skena e zbukuruar me statuja të lezetshme të formuara me tollombace të kujton menjëherë atmosferën e Krishtlindjeve që po afrojnë. Prapa skenës që herët në mëngjes vibron një emocion dhe tension pozitiv. Forever për këtë rast ka përgatitur Panairin e Krishtlindjeve dhe programin festiv më të madh.





Natyrisht që pas investimit të një pune, kohe dhe tensioni kaq të madh të gjithë dëshirojnë që aktiviteti të pëlqehet nga të gjithë: të plotësojë çdo kërkesë! Pas perdes së skenës në shikimet e tensionuara lexohet pyetja: „*A po vijmë?*” Pas orës nëntë e gjysëm vjen lajmi i parë i gëzuar: ndodhen më shumë se njëmijë vetë në korridor, mes banakëve të panairit!

E KALUAR E DENJË, E ARDHME E BUKUR

Shpirtërat e tensionuar qetësohen nga zëri i pastër i Korit të Fëmijëve **Toth Arpad**, pastaj nga loja në piano e pianistit me çmimin Kossuth **Bela Lakatos Szakcsi**.





„Ja ku e keni gati mundësinë. Shfrytëzojeni pra të gjithë!”



Drejtuesit e aktivitetit, soaring menaxherët **Tamas Biro** dhe **Diana Biro** pas hyrjes madhështore përshëndetën të mbledhurit. Mes duartrokitjeve të mëdha dhe të singërta ftojnë në skenë drejtorin gjeneral **Dr. Sandor Milesz**, i cili në përshëndetjen e tij lavdëroi rezultatet e vitit që sapo kaloi. Në skenë fton edhe anëtarët e President's Club, pastaj edhe kolegët e tij të drejtpërdrejtë që t'i falenderoj të gjithë për punën këmbëngulëse dhe të kujdesshme me të cilën kanë arritur rezultate të mira edhe në një ambient jo të favorshëm ekonomik dhe social. Pas kësaj na jep një pamje të planeve të tij në të ardhmen e afërt, na tregon vizionin e ndryshimeve të reja dhe riorganizimit duke patur si qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të efektivitetit të punës sonë. Në këtë atmosferë entuziaste paraqet mbretin hungarez të violinës **Zoltan Maga**-n. Loja e tij është vetëm gëzimi i jetës! Është e pamundur të mos prekesh nga efekti i tij! Por duke parë dëgjuesit – askush nuk përpiqet për këtë.





Drejtori Operativ i Çështjeve të Europës **Peter Lenkey** lavdëron rezultatet e vitit në nivel ndërkombëtar. Uron Gëzuar Vitin e Ri me fjalët e Istvan Szecsenyi-t: “Të guxojmë të bëhemi të mëdhenj!”

TË VEGJËL E TË MËDHENJ

Leksionin e parë profesional ia dimë për faleminderit menaxheres **Dr. Gabriella Kassai** e cila përmbledh mundësitë natyrore të ruajtjes së shëndetit duke u përqëndruar tek periudha e ftohtë. Soaring menaxherët **Dr. Terezia Samu** dhe **Andras Bruckner** me një elegancë të paparë profesionale dhe rutinë të madhe në skenë drejtojnë prezantimin e përvojave me produkte. U prezantojnë dëgjuesve një leksion tepër bindës dhe të besueshëm duke biseduar me fëmijë të vegjël e të mëdhenj.





JURIA NË GJENDJE TË VËSHTIRË

Pason pjesa më e bukur e programit. Prezantohen finalistet e konkursit të bukurisë **MISS SONYA** me muzikën dhe koreografinë dinamike të **grupit muzikor dhe kërcimtar Android**. Juria nuk ka detyrë të lehtë! Atmosfera e mirë përmirësohet mëtej nga një mysafir i rrallë dhe i njohur: muzikanti i famshëm **Toni Solymos** luan melodi të njohura duke e bërë nga minuta në minutë gjithmonë e më shumë për vete publikun prej mijëra vetësh.

Programi vazhdon me kualifikimin e supervisorëve dhe asistent menaxherëve mes festimit të turmës entuziaste. Diamant menaxherja **Veronika Lomjanski** falenderon Rex Maughan-in, ëndërruesin dhe krijuesin e Forever Living Products International Inc. për mundësinë që u krijoi qindra mijëra, madje miliona njerëzve. Falenderimi i saj është njëkohësisht edhe një mesazh për të gjithë: ja ku e kenë gati mundësinë. Shfrytëzoheni pra të gjithë!

Si mbartësit e dëshmisë së suksesit pason vlerësimi i menaxherëve, senior dhe soaring menaxherëve, si dhe i të kualifikuarve të nivelit të parë, të dytë dhe të tretë të programit motivues të makinës. Me përfundimin





e kualifikimeve na përshëndet Zëri i Forever-it, drejtori i tregëtisë **Dr. Csaba Gothard** bashkë me drejtorin gjeneral **Dr. Sandor Milesz** shpallin hapjen e Akademisë Forever Business, projektuesi i të cilit nga data 1 janar 2010 do të jetë Dr. Csaba Gothard.

NË HARMONI ME NJËRI TJETRI

Puna krijuese dhe mësimdhënëse e **Zoltan Nyiri-t** dhe **Krisztian Hackl-it** vlerësohet shumë në radhët e Forever-it. Leksioni i tyre rreth marifeteve të marketingut edhe me këtë rast pëlqehet shumë.

Pas kësaj publiku entuziazmohet nga shfaqja e shkurtër por shumë e këndshme e yjeve të muzikës së lehtë hungareze **György Korda** dhe **Klari Balazs**.

Dr. Renata Steiner shfaqet në rolin e Zanës së Krishtlindjes. Kjo zanë me kredibilitetin e karrierës së një senior menaxheri përcjell rëndësinë e vendimit personal.





Kjo pasohet në skenë nga një prej yjeve të Forever-it, **Robert Szeles**, i cili këndon një këngë interesante të adoptuar për botën e Forever-it.

Radha e leksioneve profesionale mbyllet nga dy legjenda të vërteta, diamant-safir menaxherët **Attila Gidofalvi** dhe **Miklos Berkics**. Punojnë me aq harmoni në skenë për të shprehur mesazhin e tyre, sikur punojnë çdo ditë së bashku. Pasi e praktikojnë çdo ditë së bashku! Ndoshta punojnë në dy pika të ndryshme të botës, por prapë ata i lidh fort besimi, shembulli dhe rezultati: e vendosën dhe e realizuan!





Nëse e vendos, edhe ti mund ta realizosh – është mesazhi i tyre për të gjithë.

Në programin e fundit të aktivitetit në skenë vijnë radhët e dendura të asistent supervisorëve për të marrë medaljet e tyre. U urojmë të gjithëve këmbëngulje dhe suksese të shumta në rrugën drejt realizimit të qëllimeve të tyre!

Të pranojmë këshillat e lektorëve tanë dhe të kemi një Vit të Ri të Mbarë, Forever Hungari!



Welcome HOME!

Mirëseerdhët në shtëpi!



**E PRISIM ME PADURIM
DHE EMOCION LAJMIN
E VEÇANTË: QËNDRA
E RRUGËS SZONDI
SHPËRNGULET NË
RRUGËN NEFELEJCS,
DHE PAS NDRYSHIMIT
RRJETNDËRTUESIT
MUND TA MARRIN NË
ZOTËRIM NDËRTESESËN.**

Më në fund erdhi lajmi, në 18 janar në orën 12 drejtori gjeneral Dr. Sandor Milesz na dorëzon ne, distributorëve ndërtesën e rrugës Szondi. Mezi e prisim këtë moment, pasi qendrën tonë e marrim në zotërim tashmë për herë të dytë.

Në fillim të muajit shkurt 1999, katërmëdhjetë vjet më parë në një atmosferë festive u hap qendra jonë e rrugës Szondi. Me një sallë të madhe leksionesh, dy salla të vogla takimesh, sallën e famshme Sonya®, magazinë dhe administratë kjo ishte vetë parajsa në krahasim me qendrën tonë të mëparshme të rrugës Bajza. Dhe këtu nisi një histori suksesi jo e zakonitë e FLP-s.

Në vitin 2010 mbërrijmë në një moment të ri historik, rikthehemi tek pika jonë e nisjes, dhe kështu rruga Szondi është përsëri e jona në një nivel shumëherë më të lartë. Drejtuesit e Forever-it hungarez e morrën këtë vendim të madh në vitin 2009, në mes të „krizës”: qendrën e rrugës Szondi na e dorëzojnë ne si qendër mësimore!

Në hapjen e saj Dr. Sandor Milesz na udhëhoqi me krenari në ndërtesën e rinovuar dhe të ndryshuar plotësisht. Në vend të zyrave ndërtuan salla leksionesh, krijuan një vend ku në një ambient madhështor çdo mbrëmje mund të tregojmë se sa gjeniale dhe fantastike është mundësia e FOREVER-it.

KUR HYN KËTU, TË LIND SHPRESA!

Përsëri në shtëpi! Shtëpia jonë e vjetër na pret e rinovuar, e zbukuruar dhe e zgjeruar. Magazina e dytë në Budapest e hapur në rrugën Szondi, në zemrën e qendrës së qytetit, ku na presin me gjithë paletën e produkteve dhe lëndë mësimore në zyrën e katit përdhes. Është magjeps rinovimi i mrekullueshëm i ndërtesës, krijimi i shkëlqyer dhe pajisja mjeshtrërore e sallave të leksioneve. Projektori, altoparlantet, podiumi dhe ndriçimi i skenës përbëjnë kushte të shkëlqyera teknike për prezantime dhe leksione. Kudo dallohet planifikimi i kujdesshëm edhe i detajeve më të imta.





Sandor si shenjë e vlerësimit të tij u kujdes në mënyrë të veçantë që të kualifikuarit e programit të Ndarjes së Profitit dhe anëtarët e President's Club të punojnë në tre salla takimesh ekskluzive të krijuara posaçërisht për ta. Atriumi në madhësinë e tij të vjetër, në një ambient modern dhe miqësor pret distributorët për takimet tregëtare. Bufeja bio shërben në nivelin cilësor të Szirakit pije aloe, pije freskuese, ujë burimi Sirona, sanduiche dhe sallata. Porosia e bërë në linjën e brendshme telefonike shërbehet nga bufeja në sallat e ndryshme (të profituesve, presidentëve): funksionon si një shërbim dhome.

Një nga perlat e ndërtesës është salla mësimore Sonya®. Kjo sallë me orendi fantastike është vend i denjë i prezantimit të produkteve edhe më fantastike Sonya®. Mos e lë pa shfrytëzuar!

MENDOHU MIKU IM I DASHURI!

Ndërkohë që shumë firma gjatë vitit të kaluar dështuan, falimentuan dhe pushuan njerëz, FLP-ja investon, ndërton, zgjeron dhe krijon vende pune duke besuar në të ardhmen, duke besuar tek ty! Kompania jonë investon tek distributorët dhe njerëzit e tij! Fantastike! Dhe nëse nuk e di akoma, sivjet na presin rinovime të shumta!

I dashur miku ynë konsumator, distributor dhe rrjetndërtues! Eja, shiko sallat mësimore, njohu me produktet e reja, njohu me sistemin e ri NDP, shfrytëzo mundësinë e re të blerjes,

provo produktet në sallën mësimore Sonya®!
Sandor dëshiron që të funksionojmë me kapacitet të plotë, që ndërtesa të gumëzhij nga jeta. Përhapni lajmin e qëndrës Szondi, ftoni këtu sa më shumë njerëz, tregojuni atyre stilin FOREVER, mundësinë FOREVER! Më besoni, pamja flet vetë.

I kemi të gjitha mjetet që viti 2010 të jetë një vit me të vërtetë i mirë!

Ndodhemi në vendin më të mirë! S'ka më vend për pretekste! Shfrytëzo gjithë mundësitë, puno në mënyrë të që skuadra hungareze dhe sllavo-jugore të arrijë ëndrrat e secilit prej nesh: ne jemi më të mirët në botën FOREVER!

Ju urojmë shumë punë e suksese!

Me dashuri:

Eva Keszi Szepne dhe Mihaly Szep
Soaring menaxherë





NGRITA NJË KULLË

„Jam dhe do të mbetem rrjetndërtues”



Njëzet vjet më parë nga kufiri jugor erdhën lajme shqetësuese. Në Rumani shpërtheu revolucioni. Në Hungari njerëzit shpresonin, ishin të shqetësuar dhe shikonin lajmet. Por kishte nga ata që nuk menduan, morrën valixhet dhe shkuan të ndihmojnë. I tillë ishte edhe pronari i kafenesë: Jozsef Szabo. Dhe pesë vjet më pas Hungaria filloi t'i mësonte emrin: aloe vera. Ku qëndron lidhja? Atij që nuk e di, po ia tregojmë.



Gjithë jetën time e ka pushtuar dëshira: të jetoj i pavarur – filloi Jozsef Szabo, i cili ëndërroi në Hungari Forever Living Products. Ëndrra natyrisht nuk ishte gjithmonë kaq e madhe: filloi me disa kreme dhe plotësues ushqimor, si dhe me disa netë të ftohta në parkingun e një magazine në Frankfurt.

Të jetoj i pavarur do të thotë të bëj atë që dëshiroj, të punoj me atë që dëshiroj, ta vendos vetë rrugën time dhe t'i tërheq unë vëmendje vetes sime.

Kjo s'ka qenë gjithmonë kështu?

Aspak. Kur njeriu mbaron shkollën dhe del në jetë, kujton se gjithçka do të jetë e bukur. Pastaj na japin shpulla nga të gjitha anët dhe pavarësisht se fillojmë të punojmë na duket sikur mbajmë gjithmonë një xhakë me numër më të vogël se sa ç'na duhet. Kërkoja gjithmonë vendin ku mund të gjej vetveten. Pashë një shembull: prindërit e mi – punëtorë të thjeshtë fabrike – punuan shumë që të më rrisin mua dhe motrën time të vogël. Më vonë kur u rrita dhe isha drejtori operativ dhe i sigurisë së një supermarketi, pashë shumë padrejtësi dhe asnjëherë nuk isha në gjendje të qëndroja në radhë të hierarkisë.

Dëshironit më shumë?

Natyrisht. Isha 26 vjeç dhe e pashë që me këtë pagë nuk mund të ndërtoj dot shtëpi private. Dhe unë dëshiroja shumë

të kisha një jetë më të mirë, të krijoja një jetë tjetër për vete, dhe pastaj për familjen time. Derisa u martova i hodha themelet e shtëpisë. Fillova ndërtimet me miqtë e mi në Kalaka, në një fundjavë ata ndërtonin shtëpinë time, kurse fundjavën tjetër unë i ndihmoja tek shtëpia e tyre.

Sot diçka e tillë është e vështirë të imagjinohet...

Jo, nëse e ruajmë zjarrin. Pesëmbëdhjetë vjet nga jeta ime bën fjalë rreth ndihmës që u jepja atyre që duan të shfrytëzojnë mundësinë që quhet Forever. Asnjëherë s'jam menduar se çfarë kërkojnë njerëzit nga biznesi, sa herë kërkojnë ndihmën time, gjithmonë kam shkuar dhe nuk kam refuzuar asnjë leksion. Për këtë jam krenar, është mirë të jetosh kështu, dhe pothuajse e harrova, për këtë edhe paguhem.

Por besoj keni bërë disa rrugë anësore derisa e gjetët stacionin e fundit...

Kur lindën fëmijët e mi, djali Tamas dhe vajza Laura, që nga ky moment gjithë jeta ime bënte fjalë rreth familjes. S'kishte ndodhur akoma ndryshimi i sistemeve, dhe unë dëshiroja të bëhesha tregëtar, dhe si biznesi i parë privat i qytetit hapa një kafane.

Por ju nuk kishit bërë as shkollë tregëtie...

Jo, por një gjë e dija: që më pëlqen

shumë kur më shërbejnë. Dhe kështu i shërbeja edhe klientët. Dhe kjo pati rezultat, shpeshherë mbushej plot edhe tarraca, majde njerëzit uleshin edhe jashtë në trotuar...

Por prapë thoni se e kërkuat për një kohë të gjatë vendin tuaj.

Deri në moshën 38 vjeç. Hapa dyqan akulloresh, u përpoqa... por në një farë mënyre nuk e ndjeja të isha aty ku dëshiroja.

Rrugëzgjidhja erdhi nëpërmjet një telefonate. Shumë prej jush e keni dëgjuar këtë histori, Anton Gajdo morri në telefon nga Mannheimi: më ofroi një mundësi të shkëlqyer biznesi. Dhe rastësia: ai telefoni kur Jozsef ishte në Gjermani. Por prapë... zoti Szabo i tha tre herë jo, pastaj për herë të katërt u nënshtrua. Ashtu siç thotë ai, i interesonte dukuria, e pa që ajo i tërhiqte njerëzit, që bënte fjalë rreth pavarësisë, vetëm që nuk po e shikonte akoma se ku ndodhet paraja tek kjo. Së shpejti edhe kjo u bë e qartë... natyrisht, jo vetëvetiu: në vitin e mëpashtëm Jozsef e bëri më shumë se tridhjetë herë rrugën ndërmjet Debrecenit dhe Frankfurtit, kishte raste kur fjeti edhe jashtë, përpara magazinës. Morri shumë kundërshtime, edhe ai vetë ishte i pasigurt, por gjithmonë kishte ndonjë njeri që provonte ndonjë produkt. Dhe produktet i dhanë të drejtë atij: dalëngadalë, por nga hapi në hap procesi filloi të funksiononte.



U deshën muaj të tërë derisa i mbusha mendjen Miki Berkics-it, prita disa muaj që Agi Krizso të thoshte po, dhe ishte një gëzim i madh kur pas një pune të lëkundur njëvjeçare u shfaq distributorja e parë mjeke e Hungarisë. Dr. Gabriella Kassai.

Që atëherë gjërat u përshpejtuan shumë. E mendoja se brenda pesëmbëdhjetë vitesh mund arrijnë deri këtu?

E mendoja se mund të krijonim një diçka të madhe, por jo kaq të madhe. Por isha i sigurt se nëse sillem në mënyrë etike, nëse këtu vlerësohet ndershmëria dhe këmbëngulja, atëherë do të ketë njerëz që do e pëlqejnë. E dija që rruga e Forever-it s'mund të jetë ndryshe. Dhe ata që e ndoqën këtë, qëndruan dhe hodhën rrënjë.

Por s'mund të bëhen të gjithë të suksesshëm...

Të gjithë mund të bëhen, por s'jemi në gjendje të ndryshojmë.

Pra edhe ju duhet të ndryshonit?

Shumë. Ky biznes na bën të kujdesshëm dhe të mençur, sot jam më i matur, më tolerant me të tjerët dhe e shoh në mënyrë pozitive botën. Nëse dikush e bën këtë në mënyrë të mjaftueshme, herët a vonë e ndjen atë, prandaj nuk e pranoj që s'mund të bëhen të gjithë të suksesshëm. Natyrisht duhen bërë sakrifica. I duhet kushtuar kohë vështirësive për t'i mposhtur ato.

Cilët të ndoqën në këtë rrugë?

Isha 26 vjet i martuar, 12 vjet prej këtyre si anëtarë të Forever-it. I rekomandoj të gjithëve që nëse jeni të martuar, integrojeni që në fillim bashkëshorten tuaj. Më kujtohet

shpeshherë mbishkrimi që ndodhej në kopertinën e pasme të librit të leximit të shkollës fillore, një thënie nga Attila Jozsef: „Punën e të tjerëve di ta vlerësoj vetëm ai që punon edhe vetë.” Me fjalë të tjera duhet të ecim krah për krah me njëri tjetrin, se nëse njëri prej nesh mbetet prapa, kjo mund të bëhet shkak për ndarje.

Edhe fëmijët e Jozsef-it zgjodhën rrugë tjetër: sot djali i tij 26 vjeçar mbaroi IBS-in (ekonomi biznesi ndërkombëtar), kurse vajza e tij 20 vjeçare vazhdon për gazetari në Universitetin Corvinus. Jozsef u përpoq t'u përcjell atyre një nga parimet kryesore të jetës së tij: të blesh peshk apo të mësosh të peshkosh, s'është e njëjta gjë. - *Këtë ua mësojmë edhe kolegëve tanë dhe përpiqem t'ua shpjegoj këtë edhe atyre që jetojnë rreth meje. – shpjegon ai.*

Nëse në jetën private jo të gjitha gjërat shkuan ashtu siç dëshironte Jozsef-i, në jetën e biznesit lulëzoi plotësisht. Dhe ashtu siç thotë zoti Szabo, nuk luftoi për këtë. – Në fillim nuk ishte paraja ajo që pashë, por më pëlqeu sfida dhe më motivoi dëshira për të parë botën. Pastaj kur u hap tregu hungarez dhe Rex Maughan në hotelin Hyatt tha se në vitin e ardhshëm na fton në takimin botëror në New York, kjo ishte një ndjenjë e paparë.

Nuk kishit dëshirë për t'u ngjitur gjithmonë e më lart?

Nuk kisha ambicie të tilla. Jam rrjetndërtues dhe do të mbetem gjithmonë i tillë. Kjo është një punë skuadre, secili luan rolin e vet në këtë makineri të madhe. Rrjetndërtuesit përbëjnë bazën e saj, por aty ndodhen edhe ata që e shërbejnë rrjetin duke na udhëhequr bashkë me Dr. Sandor Milesz. Gëzohem që e gjeta këtë, me të cilën arritëm një sukses të pabesueshëm në rajonin e Europës Qendrore.





Dhe cili është suksemi juaj personal?

Më e rëndësishmja është që mund të jetoj ashtu si ma dikton shpirti, në mënyrë të pavarur. Duke mos marrë parasysh disa vështirësi të vogla, jam i sigurt se kjo është ajo që dëshiroja nga jeta. Sot kam 1 milion partnerë në Europë – megjithëse 70 përqind të tyre as nuk i njoh – dhe ky numër zgjerohet gjithmonë e më shumë. Tregu s’ka kufij, vijnë gjeneratat e reja, 18-25 vjeçarët të cilët luanin me lojra fëmijësh kur unë e fillova. Idea është: ne të jemi pika konstante.

Por edhe „pika konstante” ka parë ndryshime të shumta ndërkohë.

Jo shumë kohë më parë u ktheva nga Rumania ku mbajta tre leksione dhe më pritën në një hotel me pesë yje. Aty ishte edhe ajo zonja e cila dymbëdhjetë vjet më parë e filloi biznesin në rrethana të vështira me tre fëmijë. Përpara nesh ndryshojnë fatet... M’u kujtua edhe kur para dhjetë vitesh, po aty në Bukuresht po nxitoja të mbaja një leksion. Bëra gjashtëqind kilometra vajtje dhe gjashtëqind ardhje, dhe s’erdhi asnjëri. Kurse tani më dëgjuan dyqind vetë. Sipas meje në Forever nuk mund të arrihen rezultate nga njëra ditë në tjetrën, por nga njëri vit në tjetrin mund të arrihen rezultate serioze.

Jemi përpjekur disa herë ta pyesim Jozsef Szabo-n që çfarë bën kur nuk punon. Por në një farë mënyre nuk e kupton pyetjen. – Kur nuk punoj? – pyet. – Çfarë quajmë punë? Kalon një kohë e gjatë derisa e kuptojmë se ai nuk i ndan ditët në ditë pune dhe „të tjera”. Pasi për atë Forever nuk është thjeshtë punë, por një mënyrë jetese. Më në fund pas një presioni të gjatë i vjen ndër mend se cili është pasioni i tij. Në një farë mënyrë edhe atë ia di për faleminderit FLP-s...

Nëse kompania nuk na çon në ndonjë vend të botës, atëherë shkojmë vetë – thotë dhe i radhit ato: Në gjirin Milford të Zelandës së Re kam lundruar me anije njëqind metra larg fokave. Kam qenë në Japoni, në ishujt Filipine, s’kam parë ndonjëherë tjetër në jetën time rërë aq të bardhë... Destinacioni i fundit ishte Turqia „me miq jashtë Forever-it” – siç shprehet krijuesi. Nuk u besojmë veshëve: ekzistojnë akoma njerëz të cilët Jozsef Szabo nuk i ka bindur dot?

Duhet të përpiqemi t’u ngacmojmë kureshtjen të tjerëve, por nëse nuk e arrijmë dot, kjo duhet respektuar. Kështu do të bëhemi gjithmonë e më shumë. Ne konsumohemi, pasi kemi një rrugë të natyrshme në këtë jetë, por Forever dhe mentaliteti i tij është i pavdekshëm.



Happy
Birthday! 19



JEMI KRENAR PËR TË KALUARËN DHE NA PRET NJË E ARDHME MË E BUKUR

Në 12. 12. 2009 festuam përvjetorin e nëntë të FLP Bosnia-Hercegovinës. Bijelina u pushtua nga mysafirët e ardhur nga Bosnia-Hercegovina, Serbia, Sllovenia, Kroacia, Kosova dhe Shqipëria.

Përvjetori i Bijelinës nisi shumë mirë. Për drejtimin e programit u kujdes kolegu dhe miku ynë i mirë **Tibor Radoczki**: na kujtoi fillimet e FLP Bosnia-Hercegovinës, vitet kur luajti një rol të rëndësishëm. Të gjithë ne u gëzuam shumë për drejtuesin e programit.

Drejtori rajonal i FLP Bosnies **Dr. Slavko Paleksić** përshëndeti pjesëmarrësit, i falenderoi ata për lojalitetin e tyre dhe theksoi rëndësinë e punës në skuadër dhe mentalitetin e përbashkët. Mes duartrokitjeve të mëdha i dërguam falenderime **Rex** dhe **Gregg Maughan**-it, si dhe **Aidan O'Hare**-s.





KËRKIM DORE NË SKENË

Drejtori gjeneral **Dr. Sandor Milesz** theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të gjithë vendeve dhe korrektësisë së mardhënieve kolegjiale, dhe falenderoi distributorët drejtues dhe anëtarët e rinj për besimin që kanë në punën tonë.

Rrugët e fatit janë të panjohura. **Dr. Goran Franjić** dhe **Dr. Nedim Bahtić** kanë qenë shokë shkolle, por për shkak të luftës rrugët e tyre u ndanë. U takuan përsëri nën krahët e FLP-s dhe tani e ndërtojnë së bashku rrjetin. Në leksionin e tyre interesant, profesionist dhe të qartë folën bukur rreth produkteve. Ju lavdërojmë!

Senior menaxherët **Safet** dhe **Subhija Mustafić** në leksionin e tyre të shoqëruar me shfaqje skenike mes gazit dhe nxitjes së madhe improvizuan takimin e parë të sponsorit me kolegun e ri. Parimet e Safet-it i dhanë përgjigje çdo preteksti të lindur. Leksioni i tij i pëlqeu aq shumë gruas së tij Subhija-s, sa që ajo i kërkoi të martoheshin edhe njëherë. Ky program show morri fund me një happy end të vërtetë. Ishte një leksion i shkëlqyer, përgëzime!

FYTYRA TË REJA MES NESH

Skena u mbush plotë me konsumatorë të kënaqur të cilët shkëmbyen me ne përvojat e tyre me produkte. Këtë pjesë të programit e drejtoi senior menaxherja me përvojë të madhe profesionale **Dr. Branka Molnar-Stantić**.

Pas kësaj erdhi kualifikimi i supervizorëve, asistent menaxherëve dhe menaxherëve të rinj, i cili ishte më i madhi ndërmjet gjithë atyre të deritanishëm. Edhe ky rezultat tregon qartë që bëhemi gjithmonë e më të mirë!





Atmosfera u gjallërua akoma më shumë falë programit të shkurtër por me efekt të grupit **KUM i KUM**, dhe në sallë të gjithë u ngritën në kërcim.

Kjo u pasua prej një nga pikave kulminante të mbrëmjes, grupit **Android** që qëndronte pranë Dr. Sandor Milesz-it. Muzika e tyre me melodi fantastike dhe efekte të shkëlqyera na magjepsi plotësisht. Në skenë u shfaqën konkureset e Miss Sonya të rajonit sllavojugor: pamë harmoninë e bukurisë dhe muzikës së mirë. Kërcimtarët përzierë në mënyrë tepër origjinale baletin me kërcimet orientale dhe break dance. Gjithë juria përbëhej nga njerëz të njohur. Ishte një mbresë e mrekullueshme dhe jashtëzakonisht e bukur.

Ndërmjet konkuresve u zgjodh menaxherja nga Serbia **Aneta**

Dimitrovski (ndërkohë që çdo vajzë ishte „më e bukura”), e cila do e përfaqësojë rajonin tonë në Rallyn Europian të Londrës.

Senior menaxheri **Vasilje Njegovanović** në leksionin e tij me titull „Shkojmë mëtej” bëri një pasqyrë të rrugës së kryer bashkë me fëmijët e tij (gjithashtu menaxherë) dhe të historisë së suksesit të FLP Bosnia-Hercegovinës. U bindëm përsëri që Vaso është me të drejtë anëtar i përhershëm i President's Club.

Në fund të aktivitetit tonë u shfaqën dy drejtues të mëdhenj e të shkëlqyer: safir menaxheri **Jozef Szabo** dhe diamant menaxherja **Veronika Lomjanski**.

FLASIM TË NJËJTËN GJUHË

Me ndihmën e përkthimit të shkëlqyer të Tibor Radoczki-t





Jozsef Szabo foli rreth nevojës së ndryshimeve. Theksoi se jemi të gjithë njëloj, prandaj të ngjitemi gjithmonë e më lart duke mos i harruar ata që na vijnë nga pas ose krahas nesh. „Mos harroni që të gjithë i përkasim një skuadre! Mes nesh s'ka njeri të madh, sepse për punën e kryer secili e meriton vlerësimin.”

Dëgjuam një leksion motivues dhe plot me ndjenja. Ishte aq i qartë sa që na u duk sikur po na fliste në gjuhën boshnjake. Sikur edhe vetëm për këtë leksion ia vleu që bëmë me mijëra kilometra.

Diamant menaxherja e parë e rajonit tonë **Veronika Lomjanski** me mënyrën e saj karakteristike, të çiltër dhe të fuqishme i ftoi të gjithë që të bashkohen me ne. Foli

rreth realitetit dhe realizimit të ëndrrave. Në çdo rast kur e shikojmë dhe e dëgjojmë Veronikën na shfaqet përpara një pamje e re e të ardhmes, sepse prej saj rrezaton profesionizmi dhe dashuria e sinqertë si nënë. Ju falenderojmë për gjithçka, Veronika dhe Stevo! Jeni kulla ndriçuese të përhershme për ne!

Aktivitetin e përvjetorit tonë e përfunduar me kualifikimin e asistent supervisorëve, e cila është shkalla më e rëndësishme në rrugën drejt niveleve më të larta. Ju intereson se si festuam më pas në hotel? Nuk ua tregojmë, më mirë vitin e ardhshëm ejani edhe ju me ne që të bindeni vetë rreth saj.


Dr. Slavko Paleškić
Drejtori rajonal i
FLP Bosnia-Hercegovinës



CONQUISTADOR

TOP 10 CLUB

HUNGARIA



1. **SIKLÓSNÉ DR. RÉVÉSZ EDIT**
SIKLÓS ZOLTÁN
2. **MAYER PÉTER**
3. **HALMI ISTVÁN**
HALMINÉ MIKOLA RITA
4. **FEKETE ZSOLT**
RUSKÓ NOÉMI
5. **JUHÁSZ CSABA**
BEZZEG ENIKŐ
6. **LIPP SZILVIA**
MOLNÁR MIHÁLY
7. **DR. SURÁNYI KATALIN**
GAZDIG SÁNDOR
8. **UTASI ISTVÁN**
UTASI ANITA
9. **TÓTH ISTVÁN**
ZSIGA MÁRTA
10. **MAYER BALÁZS**

SERBIA

1. **DIMITRIĆ RUŽICA**
DIMITRIĆ ŽIVORAD
2. **BRANKOVIĆ MILKA**
BRANKOVIĆ NOVAK
3. **DR. TUMBAS DUŠANKA**
4. **KORODI KOVAČ ELIZABETA**
KORODI JOŽEF
5. **JOVANOVIĆ MIRJANA**
JOVANOVIĆ MILAN
6. **JAKUPAK VLADIMIR**
JAKUPAK NEVENKA
7. **ZEČEVIĆ BOBAN**
ZEČEVIĆ DUŠANKA
8. **PETKOVIĆ ALEKSANDRA**
PETKOVIĆ BOGDAN
9. **ŠUNDOVIĆ GORDANA**
ŠUNDOVIĆ PREDRAG
10. **HRČNJAR JASNA**



DHJETË DISTRIBUTORËT MË TË SUKSESSHËM
TË MUAJIT DHJETOR 2009 NË
BAZË TË PIKËVE PERSONALE DHE TË NON-MENAXHERIT

KROACIA



1. ČALUŠIĆ DUBRAVKA
ČALUŠIĆ ANTO
2. PAVIĆ BOJANA
PAVIĆ ANTO
3. STILIN TIHOMIR
STILIN MAJA
4. SUKSER MARGARETA
SUKSER MARIJAN
5. PETROVIĆ JASMINKA
PETROVIĆ MIRKO
6. ČOP NELA
7. ŽANTEV ANDREA
8. MILJAK RILL IVANKA
RILL ROLF
9. ROGIĆ ELVISA
ROGIĆ JAKOV
10. MIRKOVIĆ NATALIJA

BOSNIA-HERCEGOVINA

1. ILIJIĆ ZDRAVKA
ILIJIĆ FILIP
2. MUSTAFIĆ SUBHIJA
MUSTAFIĆ SAFET
3. DR. FRANJIĆ GORAN
4. ZEČEVIĆ SNEZANA
5. NJEGOVIĆ ZORAN
6. DR. BAHTIĆ NEDIM
BAHTIĆ BELMA
9. BABIĆ MIRKO
BABIĆ NADA
8. ALIĆ AMINA
ALIĆ FUAD
9. BOSNIĆ MILJKA
10. JOVANOVIĆ RADOJKA
JOVANOVIĆ ŽARKO



SLOVENIA



1. ZORE JOŽEFA
2. SMILJANIĆ PETRA
SMILJANIĆ MARKO
3. ARBEITER JOŽICA
DR. ARBEITER MIRAN
4. CVIJANIĆ ANA
CVIJANIĆ BOŽIDAR
5. HOFSTÄTTER DAŠA
JAZBAR MARKO
6. BIGEC DANICA
7. ŠLIBAR KARMEN
8. KEPE ANDREJ
HOFSTÄTTER MIŠA
9. KREJČI HRASTAR MARJETA
HRASTAR MILAN
10. CVIJANOVIĆ V. ALJOŠA
CVIJANOVIĆ V. DANIJEL





NIVELIN E MANAGER-IT E ARRITËN (SPONSOR)

Andriska József

(Fekete Zsolt dhe Ruskó Noémi)



Görbics Orsolya Judit dhe Demcsák L. Miklós

(Haim Józsefné dhe Haim József)

„I përhëndesim të gjithë. Jetojmë në Szeged prej tre vitesh në marrdhënie harmonike. Sponsorët tanë janë çifti Haim. Jozsi; Forever together. Lojaliteti ynë ndaj kompanisë Forever dhe produkteve të saj është i pafund. Ia dimë për nder shumë njerëzve, por është për t'u theksuar karizma e mentorit tonë Miki Berkics. Jemi besimtarë të angazhuar të gjithë asaj që na mëson, të cilën e kryejmë edhe në praktikë.”

Hódi László dhe Hódiné Vlasits Imelda

(Lipp Szilvia dhe Molnár Mihály)

„Nëpërmjet FLP-s hymë përsëri në një skuadër ku pikësynimet e mëdha mund të arrihen vetëm duke punuar së bashku, për njëri tjetrin. Falenderojmë sponsorët tanë të cilët si trainerë të mirë na frymëzuan dhe patën besim tek ne, si dhe distributorët tanë pa të cilët nuk do i arrinim dot qëllimet tona. Është një kënaqësi e veçantë për ne që si rezultat i punës në skuadër mund të kualifikohemi së bashku me sponsorët tanë, si dhe me shokun e skuadrës dhe gruan time me të cilët kam përjetuar shumë suksese në sport. Ky është sukses i vërtetë!”



Mikola Andrásné

(Halmi István dhe Halminé Mikola Rita)

„Thonë që në fillim punë, pastaj shplodhje. Kurse ne themi: e para është familja, i dyti argëtimi, pastaj vjen puna. Është fantastike që në FLP biznesi na jep kohë edhe për familjen, edhe për argëtim, dhe kështu puna nuk na duket punë. E bëjmë me kënaqësi!”



SË BASHKU NË RRUGËN DREJT SUKSESIT

K O S O V A , S E R B I A , M A L I I Z I , S L O V E N I A



NIVELIN E ASSISTANT MANAGER-IT E ARRITËN

Bakai Réka
Branković Milka dhe Branković Novak
Dr. Francia Boglárka
Dr. Nagy Csilla dhe Zsebe Ferenc
Karczagné Rózsavölgyi Rita
dhe Karczag Tamás
László Réka
Mayer Balázs
Móczárné Putnoki Zita
dhe Móczár Béla
Pavić Bojana dhe Anto
Šlibar Karmen
Spolár Antal dhe Bollókné Nagy Mária



NIVELIN E SUPERVISOR-IT E ARRITËN

Adamóczi László
Andó László dhe Andóné Bradics Viktória
Bercsényi Szandra Éva dhe Sándor Tamás
Dobos Erika Éva dhe Zsuga Gábor
Domonkos Jánosné
Dr. Tóth Julianna
Dr. Szunai Mária
Emődi Sarolta dhe Czebe Márton
Fodor Istvánné
Gazdig Dóra
Gazdig Márton
Gomilanović Tijana
Gömöri Gáborné
Gömöri Enikő
Hegedűs Gyöngyi
Huszák Sándor dhe Huszák-Palotás Nikolett
Izsvák János Józsefné
Jovanović Mirjana dhe Jovanović Milan
Kertenics József
Kiss Attila
Kiss Zoltán
Kothencz István dhe Kothencz Istvánné
Kurucz István dhe Kurucz-Dékány Mónika
Kurucz Zsuzsanna dhe Kupás Deák László
László Zsuzsanna dhe László Balázs
Lakatos Beáta
Magda Imréné dhe Magda Imre
Maklári Annamária
Maklári-Tót Attila
Mirković Natalija

Morvainé Szabó Edit
Nádasdiné Gecse Gyöngyi
Pápai István
Pomázi László
Popović Slavica dhe Popović Nenad
Rác Gábor
Dr. Radivojević Predrag
Sasvári Erzsébet
Schlaféne Morzsányi Edit
Schmidt József dhe Schmidt Józsefné
Sulyok Mónika dhe Rácsay László
Šundović Gordana dhe Šundović Predrag
Szász Judith Gabriella dhe Mihály Levente
Tomsic Milija
Tripsigálné Tanoss Katalin
dhe Tripsigálcz Dimitrov
Tögyerné Csik Julianna
Tóth Viktória
Tóth István dhe Varga Judit
Tóth Zoltán Krisztián
Tóthné Árvai Erzsébet dhe Tóth Gábor
Vargáné Tarr Mária
Varga László dhe Rémai Margit
Virág Attiláné Ádám Irén dhe Virág Attila
Virágné Kaló Ágnes



FITUESIT E PROGRAMIT MOTIVUES TË BLERJES SË MAKINËS

NIVELI 1

Ádámné Szöllösi Cecília dhe Ádám István

Bakó Józsefné dhe Bakó József
Balázs Nikolett
Balogh Anita dhe Süle Tamás
Bánhidya András
Becz Zoltán dhe Becz Mónika
Bodnár Daniela
Botka Zoltán dhe Botka Zoltánné
Czeléné Gergely Zsófia
Csepi Ildikó dhe Kovács Gábor
Csuka György dhe dr. Bagoly Ibolya
Csürke Bálint Géza dhe Csürke Bálintné
Dobsa Attila dhe Dobsáné Csáki Mónika
Goran Dragojević dhe Irena Dragojević
Éliás Tibor

Dr. Farády Zoltán dhe dr. Farády Zoltánné
Farkas Gáborné dhe Farkas Gábor
Fittler Diána
Anton Gajdo dhe Olivia Gajdo
Gecző Éva Krisztina
Gecző László Zsoltné dhe Gecző László Zsolt
Gecse Andrea
Haim Józsefné dhe Haim József
Hajcsik Tünde dhe Láng András
Halomhegyi Vilmos
Hofbauer Rita dhe Gavalovics Gábor
Jancsik Melinda
Jozó Zsolt dhe Molnár Judit
Dr. Kálmánchey Albertné
dhe dr. Kálmánchey Albert
Dr. Kardos Lajos dhe
Dr. Kardosné Hosszú Erzsébet
Kása István dhe Kása Istvánné
Kemenczei Vince dhe Tamási Krisztina
Keszlerné Ollós Mária dhe Keszler Árpád
Kibédi Ádám dhe Ótos Emőke
Kis-Jakab Árpád dhe Kis-Jakabné Tóth Ibolya
Klaj Ágnes
Sonja Knežević dhe Nebojša Knežević
Knisz Péter dhe Knisz Edit
Kovács Gyuláné dhe Kovács Gyula
Köves Márta
Jadranka Kraljić Pavletić dhe Nenad Pavletić
Kulcsárné Tasnádi Ilona dhe Kulcsár Imre
Lapicz Tibor dhe Lapiczné Lenkó Orsolya
Dr. Predrag Lazarević dhe
Dr. Biserka Lazarević
Léránt Károly dhe Lérántné Tóth Edina
Lipp Szilvia dhe Molnár Mihály
Lukács László György
Dr. Lukács Zoltán dhe
Dr. Lukácsné Kiss Erzsébet
Major István dhe Majorné Kovács Beatrix
Mayer Péter
Mészáros Istvánné
Branko Mihailović dhe Marija Mihailović
Miklós Istvánné dhe Tasi Sándor
Mirjana Mičić dhe Vilmoš Harmoš
Mohácsi Viktória
Molnárné Kalcsu Klára
Mrakovics Szilárd dhe Csordás Emőke
Mussó József dhe Mussóné Lupsa Erika
Nagy Ádám dhe Nagyné Belényi Brigitta
Nagy Gabriella dhe Márkus József
Nagy Zoltán dhe Nagyné Czunas Ágnes
Marija Nakić dhe Dušan Nakić
Oltvölgyné Zsidai Renáta



FOREVER



Orosz Ilona dhe dr. Gönczi Zsolt
Orosz Lászlóné
Papp Imre dhe Péterbencze Anikó
Papp Tibor dhe Papp Tiborné
Dr. Pavkovics Mária
Radics Tamás dhe Poreisz Éva
Radóczki Tibor dhe dr. Gurka Ilona
Ramhab Zoltán dhe Ramhab Judit
Ráth Gábor
Rezván Pál dhe Rezválné Kerek Judit
Róth Zsolt dhe Róthné Gregin Tímea
Rudics Róbert dhe
Rudicsné dr. Czinderics Ibolya
Rusák József dhe Rusák Rozália
Rusák Patrícia
Dr. Steiner Renáta
Dr. Surányi Katalin dhe Gazdig Sándor
Tihomir Stilin dhe Maja Stilin
Sulyok László dhe Sulyokné Kökény Tünde
Szabados Zoltán dhe Szabadosné Mikus Emese
Szabó Ildikó
Szabó Péter
Dr. Szabó Tamásné dhe dr. Szabó Tamás
Szeghy Mária
Székely János dhe Juhász Dóra
Szekér Marianna
Széplaki Ferencné dhe Széplaki Ferenc
Tanács Erika
Tanács Ferenc dhe Tanács Ferencné
Tasnády Beáta dhe Vörös Zoltán

Téglás Gizella
Térmegi Lászlóné dhe Térmegi László
Tordai Endre dhe Tordainé Szép Irma
Tóth Tímea
Dr. Dušanka Tumbas
Túri Lajos dhe Dobó Zsuzsanna
Miodrag Ugrenović dhe Olga Ugrenović
Vareha Mikulas
Varga Zsuzsa
Visnovszky Ramóna dhe Bognár Gábor
Vitkó László
Zakar Ildikó
Jozefa Zore

NIVELI 2

Botis Gizella dhe Botis Marius
Császár Ibolya Tünde
Dominkó Gabriella
Hertelendy Klára
Illydhe Ilona
Dragana Janović dhe Miloš Janović
Milanka Milovanović és
Milisav Milovanović
Daniela Ocoljić
Dr. Marija Ratković
Révész Tünde dhe Kovács László
Rózsashegyi Zsoltné dhe Rózsashegyi Zsolt
Siklós dr. Révész Edit dhe Siklós Zoltán
Szépné Keszi Éva dhe Szép Mihály

Tóth Csaba
Varga Géza dhe Vargáné dr. Juronics Ilona

NIVELI 3

Berkics Miklós
Bíró Tamás dhe Bíró Diána
Bruckner András dhe dr. Samu Terézia
Budai Tamás
Marija Buruš dhe Boško Buruš
Fekete Zsolt dhe Ruskó Noémi
Halmai István dhe Halminé Mikola Rita
Herman Terézia
Juhász Csaba dhe Bezzeg Enikő
Dr. Kósa L. Adolf
Krizsó Ágnes
Leveleki Zsolt dhe Leveleki Anita
Stevan Lomjanski dhe Veronika Lomjanski
Dr. Németh Endre dhe Lukácsi Ágnes
Zoran Ocoljić
Senk Hajnalka
Dr. Seresné dr. Pirkhoffer Katalin
dhe Dr. Seres Endre
Szabó József dhe Szabó Józsefné
Tamás János dhe Tamás Jánosné
Tóth István dhe Zsiga Márta
Tóth Sándor dhe Vanya Edina
Utasi István dhe Utasi Anita
Vágási Aranka dhe Kovács András
Varga Róbert



ZGJIDHNI MES OFERTAVE TONA,
PRIJENI KUPONIN DHE JU
BËJMË ULJE ÇMIMI PREJ
10.000 FT!

FOREVER RESORTS

“Elegancë sipas kërkesave aktuale”

web: www.kastelyszirak.info • tel.: 06 32 485 300 • mail: info@kastelyszirak.info

Prijeni dhe silleni me vete!

Kuponi mund të përdoret për marrjen në përdorim të ofertave të Hotelit Kështjella e Szirakit.
Për një ofertë mund të përdoret vetëm një kupon dhe nuk mund të kombinohet me ulje të tjera çmimi. Për informacione të mëtejshme interesohuni duke u kontaktuar me ne.

Këto ofertat gjenden në faqen tonë të internetit!

KUPON 10000 FT-SH



web: www.kastelyszirak.info
mail: info@kastelyszirak.info
telefon: 06 32 485 300

I vlefshëm deri në: 28 shkurt 2010



Suksesi i vërtetë

VIKTORIA CZINKOTA, FITUESJA E KONKURISIT MISS SONYA® NË VENDIN TONË

Ka vetëm një vit që është distributore e FLP-s, dhe arriti një rezultat tepër serioz. Përparon mirë edhe në biznes, por vlerësimin më të madh e morri tani afër për ndjenjën e bukurisë dhe paraqitjen e saj të jashtme. Duke qenë maksimaliste natyrisht nuk kënaqet me kaq.

Produktet FLP fillimisht i bënë mirë nënës sime, dhe kjo më nxiti të filloj të merrem me to – tregon rreth fillimit Viktoria Czinkota, fituesja e konkursit Miss Sonya® në vendin tonë. Kjo vajzë së shpejti udhëton në Londër që të konkuroj bashkë me bukuritë e vendeve të tjera. Por këtu s'ka vlerë vetëm bukuria, por edhe qëndrimi, zotësia dhe aftësitë e shfaqura në përfaqësimin e lëndëve kozmetike cilësore. S'është çudi që Viktoria-n e tërheq kjo fushë, sepse ajo po mëson kozmetikë, krahas të cilës merret me makijazhe dhe tatuazhe. – Për këtë shkak i shikoj pak me sy tjetër produktet – thotë – mua më pëlqejnë shumë, madje edhe nga konsumatorët marr vetëm reagime pozitive.

Por konsumatorët nuk rrezikojnë shumë, pasi fytyra e Viktoria-s është referenca më e mirë. – Shumë njerëz vijnë në prezantime sepse u pëlqen makijazhi im, dhe fillojnë të interesohen. Në praktikë natyrisht edhe ata binden që kjo gjë funksionon. Kam vënë re se ata që e provojnë njëherë, nuk blejnë më produkte të tjera.

Viktoria tregon se nuk ka ngjyra të preferuara, tek ajo makijazhi varet nga gjendja shpirtërore. Por në Ditën e Sukksesit të dhjetorit ngjyra lejla i solli sukses: juria zgjodhi Viktoria-n si më të bukurën. – Fakti që më pëlqen shumë të bëj makijazh është baza e kësaj. Mendoj se edhe buzëqeshja ka shumë rëndësi. Me thënë të drejtën nuk jam mësuar të shfaqem, dhe nga emocionet bëzëqeshja. Kjo natyrisht s'është problem, dhe tani më erdhi edhe në ndihmë!

Shpresojmë që kjo do i vijë në ndihmë Vikit edhe në Londër. Vajza e re iu gëzua shumë këtij udhëtimit, pasi s'ka qenë ndonjëherë në kryeqytetin anglez. – Gëzohem shumë që fitova, sepse kam dashur gjithmonë ta shikoj Londrën, dhe kjo është një mundësi e mirë. Më pëlqen aventura dhe sfida. Dhe dëshiroj ta fitoj edhe atë konkurs, sepse dua të shkoj edhe në Amerikë!

Kujtojmë se pas një rezultati të tillë Viki është shumë e kënaqur. Por sipas saj ka gjëra që asaj nuk i pëlqejnë tek vetja. – Duke qenë maksimaliste, nuk më duket asnjëherë e përsosur vetja – tregon ajo – por s'më vjen keq, pasi çfarëdo gjëje që kam bërë, gjithmonë më duket se mund ta bëj më mirë: kjo pakënaqësi e përhershme më çon përpara në jetë. Më duket se kam çfarë të mësoj, por shpresoj se nuk veproj gabim. Sivjet dëshiroj të mbaj më shumë prezantime makijazhi, të trainoj veten dhe të punoj akoma më mirë, me gjithë fuqitë e mia. Në mënyrë që produktet të njihen nga më shumë njerëz, dhe natyrisht të ngjitem në nivelin e mësipërm.

Dhe përse i përket jetës jashtë tregëtisë? Viktoria vitin e ardhshëm përfundon shkollën dhe ka si plan që me punën e saj të ndihmoj ata që kanë nevojë me të vërtetë për ndihmën e një mjeshtrë kozmetike, makijazhi dhe tatuazhi. – Shumë njerëz që kanë kaluar operacione serioze kanë nevojë që më pas „t'u vizatohen”, t'u rikthehen dhe riformohen pjesët e lëkurës së dëmtuar. – Mendoj se këta të sëmurë e meritojnë që dikush të merret me ta. Dhe nëse do të kem sukses, ajo do të jetë një fitore e vërtetë për mua!



PROGRAME MOTIVUESE

Nga data 1 Prill 2009 fillon ALOE TRAVEL SERVICE (ATS), një klub udhëtimit i veçantë dhe ekskluziv.

Distributorët anëtarë të këtij klubi mund të udhëtojnë me çmime 20-50% më të lira.

– Distributorët me 2 ose më shumë pikë mund ta blejnë kartën e anëtarësisë në zyrat vendase të FLP-s. Çmimi i anëtarësisë është 49 €/person/vit.

– Nga data 22 tetor 2009 në vend të Travel Pack të mëparshëm shesim paketën Travel Touch prej 2,000 cc. Kjo paketë e re përveç të drejtës së blerjes me kartë-ATS përmban edhe dhurata ekskluzive të cilat deri tani merreshin vetëm në vendet e prushimit të Forever Resorts.– Për regjistrimin në klub duhet plotësuar një formular i thjeshtë ku shënohen të dhënat dhe **adresa e-mail e distributorit.**

– Distributori me kartën e anëtarësisë mund të regjistrohet në faqen e internetit të ATS, dhe me këtë bëhet anëtar online i klubit të udhëtimit.

– ATS jep ofertat e zgjedhura me 4, 5, 6 vje të agjensive të udhëtimit më të mëdha të Europës perendimore. Mendojmë se anëtarët aktiv të këtij klubi e meritojnë që të marrin pjesë në udhëtime sensacionale me çmime speciale të siguruar nëpërmjet FLP-s. Telefon: (+36-70) 434-3843 E-mail: register@aloetravel.com

RISPONSORIZIM

Rregullat e “risponsorizimit” gjenden në kapitullin e 12-të të Politikës së Biznesit. E rëndësishme është që risponsorizimi s’është proces automatik, por vjen në fuqi vetëm pas plotësimit të formularëve

të caktuar (deklarata e risponsorizimit, fletë regjistrimi e re) dhe kontrollit të plotësisë të kushteve. Në lidhje me rregullat e Politikës së Biznesit gabon ai që punonjësit distributor të regjistruar njëherë i regjistron për herë të dytë duke shmangur procesin e risponsorizimit.

INTERNET

Njoftojmë Distributorët e Nderuar se mund të marrin informacione nga dy faqe interneti të kompanisë sonë. Njëra faqe interneti www.flpsecu.com është faqja e rajonit tonë, nëpërmjet të cilës mund të kontaktoni me dyqanin tonë web. Kodet për përdorimin e dyqanit web mund t’i kërkonit në zyrat tona. Në këtë faqe numrat aktual dhe të mëparshëm të revistës Forever mund të hapen me fjalëkalimin “forever”, kurse fotogaleria me fjalëkalimin “success”. Faqja kryesore e internetit të kompanisë, apo siç quhet zakonisht “faqja amerikane” - www.foreverliving.com - njofton rreth lajmeve rreth FLP-s nga bota, mënyrave ndërkomëtare të kontaktimit, si dhe informacioneve të tjera me vlerë. Në këtë adresë mund të hyj çdo i interesuar duke klikuar mbi “Guest”. Në faqen e distributorit mund të hyni duke klikuar mbi „Distributor login”. Këtu mund të shikoni edhe rezultatin e pikëve ditore. Emrin e përdoruesit (LOGIN ID) dhe fjalëkalimin (PASSWORD) për hyrje e gjendeni në fund të llogarisë së bonusave tuaj mujor (llogaria e tregëtarit).

Llogari bonusash në faqen tonë të internetit. Çdo punonjës që zotëron fjalëkalim mund t’i shikoj llogaritë e bonusave të tij mujore në internet.

Rreth përdorimit të këtij shërbimi mund të lexoni në faqen e distributorit të foreverliving.com.

Forever You Tube. Home Office krijoi kanalën e saj Forever You Tube adresa e të cilit është: <http://www.youtube.com/user/AloePod>. Këtu rekomandojmë video prezantuese të produkteve të FLP-s, leksione të managerëve drejtues dhe prezantime të tjera marketingu në gjuhë të ndryshme. Së shpejti na krijohet mundësia e marrjes së mesazheve, si dhe mund të arrihet edhe në Blackberry.

Në lidhje me shfaqjen në internet të distributorëve

përfaqësuesit e kompanisë qëndrore ju thërrasin vëmendjen për çështjet e mëposhtme:

- në faqen e internetit nuk mund të jepen këshilla mjekuese/mjekësore;
- në faqen e internetit nuk mund të bëhen premtime në lidhje me të ardhurat;
- faqja e internetit duhet të përmbajë me çdo kusht që operatori i saj është distributor i pavarur i FLP-s dhe që kjo faqe nuk është faqe zyrtare e FLP-s;
- në faqen e distributorit nuk mund të bëhen shitje nëpërmjet internetit

Ju tërheqim përsëri vëmendjen se në bazë të pikës 14.3.3.5 të Politikës ndërkomëtare të Biznesit produktet tona nuk mund të shiten as në ankand/treg elektronik (psh. Vatera, Tesz-vesz, E-bay, etj.) Ju lutemi që çdo shfaqje në internet ta planifikoni duke marrë parasysh kriteret e mësipërme, dhe para çdo publikimi mos harroni të kërkonit leje nga Kompania. Linkun e faqes së internetit e presim në adresën qëndrore të email-it flpbudapest@flpsecu.hu.

NJOFTIME

E PARREGULLT!

Asnjëherë mos blini ose shisni produkte në kanale të tjera elektronike apo njësi të shitjes me pakicë. Duke marrë parasysh mundësitë e ndryshme të shitjes nëpërmjet medias elektronike, sipas Forever Living Products: këto konsiderohen si njësi të shitjes me pakicë. Sipas politikës aktuale të biznesit qarkullimi i produkteve ose publikimi i formularëve të FLP-s në njësitë e shitjes me pakicë është rreptësisht i ndaluar. Qarkullimi i produkteve me anë të medias elektronike mund të bëhet vetëm nëpërmjet faqes së internetit www.flpseu.com!

INFORMACIONE ME VLERË

Kompania jonë u ofron Distributorëve të saj mundësi të ndryshme re për të kontrolluar pikët e tyre:

– Në internet. Informacionin rreth kësaj e gjeni në pjesën e Njoftimeve me titull INTERNET.

– Informacione rreth pikëve mund të kërkonin edhe nëpërmjet **sistemit-SMS** që funksionon me sukses prej vitesh.

– Edhe punonjësit e **shërbimit telefonik** të zyrës sonë qendrore të Budapestit ju informojnë me kënaqësi rreth të dhënave aktuale të qarkullimit tuaj. Vlerat e pikëve personale distributorët e Budapestit mund t'i pyesin në numrin e telefonit +36-1-269-53-70 dhe +36-1-269-53-71, kurse të Kroacisë, Bosnia-Hercegovinës, Sllovenisë, Serbisë dhe Malit të Zi +36-1-322-55-41.

Ju lutemi të interesoheni vetëm për pikët dhe biznesin tuaj personal!

I lutemi Shpërndarësve tanë të nderuar që edhe në të ardhmen t'i kushtojnë kujdes plotësisht të saktë të formularëve, sidomos të fletës së regjistrimit të distributorit, e cila është kontrata ndërmjet distributorit dhe FLP-s! Formularët e korrigjuar dhe dhe të panëshkruar të regjistrimit dhe porosisë së produkteve nuk mund t'i pranojmë për shkak të shmangjes së gabimeve!

Pranojmë vetëm kontratat me nën shkrim personal! Çdo nënshkrim tjetër konsiderohet si fallçifikim doku mentash!

Në rastin e ndryshimit të adresës apo të emrit s'është e mjaftueshme ta shkruani atë në fletën e porosisë së produkteve. Për këtë ju lutemi të përdorni formularin e ndryshimit të të dhënave!

Në interes të sigurisë së çështjeve financiare ju lutemi, që në rastin e kontrollit të pikëve nëpërmjet autorizimit, personi i autorizuar të sjell me vete letërnjoftimin e tij!

Sipas Politikës Ndërkombëtare të Biznesit, çdo distributor që nënshkruan formularin e regjistrimit (kontratën), fiton të drejtën e blerjes së produkteve me çmim shumice direkt nga zyrat. Ndërkohë distributor i regjistruar ai bëhet vetëm gjatë blerjes së parë, duke paraqitur 2 kopje të formularit të regjistrimit të vulosur dhe dorëzuar më parë.



Programi në internet 22.02-22.03. 2010

18:00 dhe 06:00	Himni
18:15 dhe 06:15	Dr. Ida Nagy dhe dr. Ferenc Kiss: Mbrojtja e shëndetit në pranverë
18:40 dhe 06:40	Dr. Katalin Pirkhoffer Dr. Seresnë: Lodhje pranverore
19:10 dhe 07:10	Supervizorë, Asistent m...
19:25 dhe 07:25	Menaxherë, Menaxherë drejtues
20:10 dhe 08:10	Bela Szakcsi Lakatos
20:25 dhe 08:25	Ëndrra jote është plani ynë Mundësia FLP
20:30 dhe 08:30	Veronika Lomjanski: Faleminderit, Rex!
20:45 dhe 08:45	Katrin Bajri
21:45 dhe 09:45	Android Koncert, Miss Sonya
22:40 dhe 10:40	Zoltán Nyíri dhe Krisztián Hackl: Marifete mjeshtrërore marketingu
23:00 dhe 11:00	Supervizorë, Asistent m...
23:20 dhe 11:20	Menaxherë, Menaxherë drejtues, Sundimtarë
00:15 dhe 12:15	Tóni Solymos
00:30 dhe 12:30	Ëndrra jote është plani ynë Produktet FLP
00:35 dhe 12:35	Dr. Renáta Steiner: Jeta jote, vendimi yt
00:50 dhe 12:50	Istvan Halmi: Zgjero
01:40 dhe 13:40	Ëndrra jote është plani ynë
01:45 dhe 13:45	Róbert Szeles: Yjet e FLP-s
01:50 dhe 13:50	Dr. Edit Révész Siklósné: Antioksidantë natyror në parandalim dhe mjekim
02:30 dhe 14:30	Zoltán Nyíri dhe Krisztián Hackl: Përparësitë dhe mundësitë e llojeve të personalitetit
03:30 dhe 15:30	Klári Balázs dhe György Korda
04:00 dhe 16:00	Ágnes Klaj: Kur nëse jo tani?
04:20 dhe 16:20	Klára Hertelendy: Gjithmonë e më lartë
04:50 dhe 16:50	Gonozok dhe Zagyyva Koncert
05:05 dhe 17:05	Attila Gidófalvi dhe Miklós Berkics: Çfarë dëshiron nga kjo jetë?

www.flpseu.com



NJOFTIMET E PËRFAQËSIVE TË HUNGARISË

TË REJA

Që nga dita e sotme Telecenter zotëron numër të ri TË GJELBËR: 06-80-204-983. Ky shërbim funksionon gjatë ditëve të punës në orarin 12-16 dhe mund të telefonohet falas. Natyrisht Telecenter mund të arrihet akoma edhe në numrat e vjetër: +36-1/297-5538, +36-20-456-8141, +36-20/456-8149

KALENDARI I AKTIVITETEVE

BUDAPEST — Success Day: 2010. 02. 20.; Success Day: 2010. 03. 13.; Success Day: 2010. 05. 22.; Success Day: 2010. 07. 24.; Success Day: 2010. 09. 11.; Success Day: 2010. 10. 16.; Success Day: 2010. 11. 20.; Success Day: 2010. 12. 18.

POROSI PRODUKTESH

Blerësit që i sigurojnë produktet jo personalisht, por me autorizim mund t'i bëjnë porositë e tyre në mënyrën e mëposhtme:

– **në telefon**, ku punonjësi ynë ju jep informacione të sakta rreth shumës së porosisë, vlerës së saj në pikë dhe çmimit të transportit: +36-1/297-5538, +36-1/297-5539, cel: +36-20/456-8141, +36-20-456-8149 numri i gjelbër: +36-80-204-983 (mund të telefonohet falas gjatë ditëve të punës në orarin 12-16)

– **me sms** në numrin e telefonit +36-20/478-4732.

– **në internet**: në faqen www.flpseeu.com! Zgjidhja më e thjeshtë dhe më e sigurt – jo vetëm përsa i përket blerjes së drejtpërdrejtë të produkteve, por edhe regjistrimit të porosive. Është një mjet i shkëlqyer edhe gjatë rekomandimit të produkteve, pasi kjo ofertë është joshëse për çdo të interesuar. Vlera e pikëve të çdo porositë brenda 24 orëve i shtohet vlerës aktuale. Dyqani ynë web mund të arrihet drejtpërdrejtë në adresën www.flpshop.hu, kurse vlera e pikëve dhe mund të ndiqet me vëmendje në faqen internetit www.foreverliving.com.

BLERJE ME ULJE

Partnerët tanë me shtetësi hungareze pjesën e shpërblimit që u takon për blerjet personale mund ta marrin në formën e uljes së çmimit. Sipas kërkesës suaj uljen e zbrisim nga shumata

çeqeve të blerjes, kështu që Ju paguani më pak. Procesi i blerjes me ulje është si mëposhtë:

1. Deklarata. Nëse Ju dëshironi ta shfrytëzoni këtë mundësi duhet ta deklaroni këtë duke plotësuar formularin përkatës.

2. Blerja: Sistemi e zbrit automatikisht uljen në çmim nga shumata gjithsej. Por kjo shumë për çdo person nuk mund të kalojë 35% të shumës gjithsej neto. Nëse ulja e mbledhur në emrin Tuaj është më e madhe se kjo shumë, atëherë shumën e mbetur ua llogarisim gjatë blerjes së ardhshme, përsëri deri në vlerën 35% të shumës gjithsej të re, pastaj ky proces përsëritet mëtej.

Në rastin e blerjes me ulje nevojitet vërtetimi i identitetit Tuaj ose i personit të autorizuarit me letërnjoftim me fotografi.

3. Informimi: Shumës që mund të merret në përdorim në datën 15 të çdo muaji i shtojmë uljet e reja që rrjedhin nga blerjet e muajit të kaluar. Rreth shumës aktuale të uljes kolegët tanë mund t'ju japin informacione juve ose personit të autorizuar vetëm personalisht, pas paraqitjes së letërnjoftimit me fotografi. Për detaje të mëtejshme interesohuni tel sponsorët ose punonjësit tanë.

TRANSPORTI

Dëshiroj t'u thërras vëmendjen distributorëve të Hungarisë për shërbimin tonë të transportimit të pakove. Me anë të këtij shërbimi Ju i marrim porositë e bëra maksimum brenda 2 ditëve – në kohë të përcaktuar – në çdo zonë të vendit, të cilat duhen marrë brenda 48 orëve, pasi në rast të kundërt ato i anullojmë dhe pikët i zbrisim. Çmimi i produkteve të porositura dhe ai i transportit duhet paguar kur pakoja merret në dorë. Në rastin e blerjes me vlerë mbi 1 pikë shpenzimet e transportit paguhen nga kompania.

INFORMACIONE ME VLERË

I lutemi Distributorëve të Nderuar, që bashkë me formularin e tyre të regjistrimit të dorëzojnë edhe kopjen e lishencës së tyre të tregëtisë! Në të ardhmen vetëm me këtë dokument mund t'ju japim shpërblime! Ata partnerë të Hungarisë, të cilët për blerjet e bëra dëshirojnë të nxjerrin llogari në emrin e firmës së tyre personale, mund ta bëjnë këtë vetëm në rast se dërgojnë formularët e nevojshëm

të plotësuar, dhe një kopje të dokumentit që vërteton pozitën e tij si pronar i firmës. Njoftimi i hollësishëm në lidhje me këtë gjendet në zyrat tona, por me kërkesën tuaj mund t'ju njoftojnë edhe gojarisht.

Numrat telefonik të specialistëve tanë mjek:

Dr. Kassai Gabriella +36-20/234-2925
Dr. Kozma Brigitta +36-20/261-3626
Dr. Mezösi László +36-20/251-9989
Dr. Németh Endre +36-30/218-9004
Siklósné dr. Révész Edit +36-20/255-2122

Numri telefonik i specialistit tonë mjek të pavarur:

Dr. Bakanek György +36-20/365-5959

Produktet e Forever Living Products i nxjerrim në treg me rekomandimin e Shoqatës së Mjekësisë Popullore të Hungarisë.

PËRFAQËSITË TONA

Forever Living Products

- Qendra Mësimore: 1067 Budapest, Szondi utca 34. tel.: +36-1/332-5956, +36-20/253-3614 Menaxher projekti: Dr. Gothárd Csaba
- Drejtoria e Tregëtisë e Budapestit: 1183 Budapest, Nefelejcs u. 9–11. tel.: +36-1/291-8995, +36-20/465-6280 Drejtori i rajonit: Földi Attila
- Drejtoria Rajonale e Debrecenit: 4025 Debrecen, Erzsébet u. 48. tel.: +36-52/349-657, +36-20/914-2945 Drejtori i rajonit: Pósa Kálmán.
- Drejtoria Rajonale e Szegedit: 6721 Szeged, Tisza Lajos krt. 25. tel.: +36-62/425-505, +36-20/251-1712 Drejtori i rajonit: Radóczki Tibor
- Drejtoria Rajonale e Szekesfehervarit: 8000 Szekesfehervár, Sóstói út 3. tel.: +36-22-333-167, +36-20/467-8603 Drejtori i rajonit: Kiss Tibor

Forever Resorts

- Hoteli Kështjella e Szirakit 3044 Szirák, Petőfi u. 26. tel: +36-32-485-300, fax: +36-32-485-285. Drejtoresha e hotelit: Király Katalin Faqja e internetit: www.kastelyszirak.info





Brazil

World Rally 2010

RIO DE JANEIRO

2010. 04. 15-18.

KUALIFIKIMET:

HUNGARIA

MIKLOS BERKICS
DR. ADOLF L. KOSA

SERBIA

STEVAN DHE VERONIKA LOMJANSKI

SLLOVENIA

TOMISLAV DHE ANDREJA BRUMEC



2010

PRESIDENT'S CLUB

HUNGARIA



MIKLOS BERKICS
CC GJITHSEJ: 6057,089
I KUALIFIKUAR I PROFIT SHARING

„Viti 2010 është viti i ndryshimit, gjithçka duhet ta bëjmë më mirë dhe më shumë.”

ROBERT VARGA
CC GJITHSEJ: 4123,745
I KUALIFIKUAR I PROFIT SHARING

„Cilësia e një njeriu duket tek fakti se sa njerëz mund të ndihmoj dhe të shërbej!”



DR. ADOLF L. KOSA
CC GJITHSEJ: 3 864 710
I KUALIFIKUAR I PROFIT SHARING

„Kaluan tetë vjet, pra e mbarova filloren, dhe me një deftesë të shkëlqyer! Prandaj tani vjen shkolla e mesme, pastaj universiteti...”

ISTVAN HALMI DHE RITA MIKOLA HALMINE
CC GJITHSEJ: 3248,218
TË KUALIFIKUAR TË PROFIT SHARING

„Thonë që në fillim punë, pastaj shplohje. Kurse ne themi: e para është familja, i dyti argëtimi, pastaj vjen puna. Është fantastike që në FLP biznesi na jep kohë edhe për familjen, edhe për argëtim, dhe kështu puna nuk na duket punë. E bëjmë me kënaqësi!”



ARANKA VAGASI DHE ANDRAS KOVACS
CC GJITHSEJ: 3021,606
TË KUALIFIKUAR TË PROFIT SHARING

„Angazhim, vullnet, pikësynime të forta, shumë Miq të mirë, Skuadër e madhe, ide të përbashkëta, ritëm optimal pune, përballim Disfatash, Kreativitet i pafund.”

SANDOR TOTH DHE EDINA VANYA
CC GJITHSEJ: 2630,458
TË KUALIFIKUAR TË PROFIT SHARING

„Dëshira për sukses, besimi në vetvete, tek firma dhe drejtuesit e saj, puna e kryer me dashuri sjellin gjithmonë rezultat”





**ZSOLT FEKETE DHE
NOEMI RUSKO**
CC GJITHSEJ: 2564,541
TË KUALIFIKUAR TË PROFIT SHARING

„Praktika nuk të bën të përsosur, por të bën të vazhdueshëm.”

HAJNALKA SENK
CC GJITHSEJ: 2528,124
E KUALIFIKUAR E PROFIT SHARING



„Carpe diem – me këtë biznes në çdo moment mund të marr dhe të jap më të mirën – ka gjashtë vjet që Forever është pika e sigurt e jetës sime... dhe kjo më qetëson”



TAMAS BIRO DHE DIANA BIRO
CC GJITHSEJ: 2516,044
TË KUALIFIKUAR TË PROFIT SHARING

“Nuk njohim ndjenjë më shpresëdhënëse se aftësia e padiskutueshme e njeriut për të përmirësuar jetën e tij me përpjekje të vetëdijshme.”

**TAMAS BUDAI DHE
EVA SCHWARCZ- BUDAI**
TOTAL CC: 2503,014
CC GJITHSEJ: 2503,014
TË KUALIFIKUAR TË PROFIT SHARING



“Kërkojmë njerëz të vullnetshëm dhe etik, me të cilët mund të jetojmë të ardhmen tonë më të pasur e më të lumtur. “



**CSABA JUHASZ
DHE ENIKÓ BEZZEG**
CC GJITHSEJ: 2462,108
TË KUALIFIKUAR TË PROFIT SHARING

„Kjo është jeta jonë, për ne ky është mision.”

**ISTVAN UTASI
DHE ANITA UTASI**
CC GJITHSEJ: 2424,395
TË KUALIFIKUAR TË PROFIT SHARING



„Nëse nuk të pëlqen ajo që shikon rreth vetvetes, atëherë ka ardhur koha të ndryshosh, dhe do e shohësh që gjithçka rreth teje do të ndryshojë!”



**GEZA VARGA DHE DR. ILONA
JURONICS VARGANE**
CC GJITHSEJ: 1887,166
TË KUALIFIKUAR TË PROFIT SHARING

“Mësojmë që me diturinë tonë të bëhemi më të mirë dhe të ndihmojmë të tjerët.”

AGNES KLAJ
CC GJITHSEJ: 1656,136
E KUALIFIKUAR E PROFIT SHARING



“Nëse dëshiron diçka, gjithçka bashkohet që ta arrish atë.”





2010
PRESIDENT'S
CLUB

SHQIPËRIA BOSNIA-HERCEGOVINA KROACIA SERBIA SLLOVENIA



**ATTILA BORBATH
DHE MIMOZA BORBATH**
CC GJITHSEJ: 462,414

“Edhe të vegjëlit mund të bëhen të mëdhenj.”



SHQIPËRIA

VASILJE NJEGOVANOVIĆ
CC GJITHSEJ: 817,905

Gjithë anëtarët e familjes sime punojnë në mënyrë aktive në FLP. Edhe djali dhe vajza ime janë menaxherë! Jam shumë krenar për të gjithë kolegët e mi. Puna jonë e kryer me mentalitet, forcë dhe besim të përbashkët na siguron rezultate të shkëlqyera. Jam i lumtur që mund të jem anëtar i President's Club, mund të mësoj nga më të mirët dhe mund ta përcjell mëtej këtë njohuri.



BOSNIA-HERCEGOVINA



**SUBHIJA MUSTAFIĆ
DHE SAFET MUSTAFIĆ**
CC GJITHSEJ: 598,758

U bëmë përsëri anëtarë të President's Club dhe kjo është një ndjenjë e mrekullueshme! Ia vleu të punonim me ndershmëri, të besonim tek njerëzit dhe të rrezatonim optimizëm në mjedisin tonë rrethues edhe në këtë periudhë të vështirë. Motoja jonë është: „Mos kërko pretekste, por më mirë gjej rrugëzgjdhje!” Çdo ditë hidh një hap të ri në rrugën drejt realizimit të ëndrrave të tua.



BOSNIA-HERCEGOVINA

**MAJA STILIN DHE
TIHOMIR STILIN**
CC GJITHSEJ: 1978,98

Senior menaxherë nga Rijeka. Me skuadrën e tyre të re të FLP-s, me vajzat e tyre, Tean, Lean dhe Enin, si dhe kolegët e tyre, me ndihmën e të cilëve u bënë anëtarë me prestigj të President's Club.



KROACIA



**JADRANKA KRALJIĆ PAVLETIĆ
DHE NENAD PAVLETIĆ**
CC GJITHSEJ: 1290,899

“Të urojmë gjithë të mirat nga Rijeka. I lejova vetes edhe një MUDANSA! Sot në ndërtime e rrjetit stabil më qëndron pranë edhe bashkëshorti im, Nenad si anëtar i respektueshëm i Forever Living Products“



KROACIA

**VERONIKA LOMJANSKI
DHE STEVAN LOMJANSKI**
CC GJITHSEJ: 4 858,084
TË KUALIFIKUAR TË PROFIT SHARING

„E do apo jo, varet vetëm nga ty! Ne e donim! Me punë dhe disiplinë të madhe përparojmë në rrugën e Forever-it që të siguron sukses, mirëqenie materiale dhe jetë cilësore.“



SERBIA





**MARIJA BURUŠ
DHE BOŠKO BURUŠ**
CC GJITHSEJ: 2407,229

„FLP na ofron mundësi për një jetë më të bukur, më të mirë e më cilësore. Ne e pranuan sfidën. Sot Forever është stili ynë i jetës.”



SERBIA

**DRAGANA JANOVIĆ
DHE MILOŠ JANOVIĆ**
CC GJITHSEJ: 1622,218

TË KUALIFIKUAR TË PROFIT SHARING

„Ne nuk bëjmë punë FLP-je, por jetojmë sipas stilit të FLP-s: udhëtojmë, miqësohemi dhe ndihmojmë që të realizohen ëndrrat e miqve që punojnë në skuadrën tonë të shkëlqyer! Faleminderit Rex, Faleminderit FLP!”



SERBIA



DR. MARIJA RATKOVIĆ
CC GJITHSEJ: 1611,624

„Jam e lumtur sepse para dymbëdhjetë vitesh e kuptova efektin e mirë dhe me vlerë të produkteve të FLP-s, si dhe për shkakun se kam ndihmuar shumë njerëz të realizojnë ëndrrat e tyre. Deri tani kam marrë pjesë në çdo Rally European dhe kam qenë dhjetë herë në Shtetet e Bashkuara! Në vitin 2006 morra në Stockholm çekun si e kualifikuar e Profit Sharing. Kam qenë nëntë herë anëtare e President's Club!”



SERBIA

**MIRJANA MIĆIĆ
DHE VILMOŠ HARMOŠ**
CC GJITHSEJ: 1193,89

„Kishim pikësynime të mira, të mëdha, të gjera, humane dhe të thella, prandaj filluam të punonim në FLP. Merremi me atë që dëshirojmë, dhe na pëlqen puna që bëjmë.”



SERBIA



**DR. ALEKSANDAR PETROVIĆ
DHE MIRJANA ĐUKNIĆ
PETROVIĆ**
CC GJITHSEJ: 723 558

„Jemi menaxherë që nga viti 2007. Mirjana hoqi dorë që atë vit nga puna si nëpunëse në bankë. Merremi vetëm me FLP-n. Biznesi më i madh i jetës sonë!”



SERBIA

**TOMISLAV BRUMEC
DHE ANDREJA BRUMEC**
CC GJITHSEJ: 1209,341

Andreja dhe Tomo Brumec e vazhdojnë në mënyrë të shkëlqyer punën që filloi Tomo para se të hapej përfaqësia e FLP-s në Slloveni. Tomo në vitin 2008 morri çmimin Top Manager, dhe jemi të bindur që bashkë me Andrian do të ngjiten gjithmonë e më lart.



SLOVENIA

**JOŽICA ARBEITER DHE DR.
MIRAN ARBEITER**
CC GJITHSEJ: 667,182



„Natyrshtëm dhe me efekt!”



SLOVENIA



NJOFTIMET E ZYRAVE



SERBIA

Zyra e Beogradit: 11000 Beograd, Kumodraska 162, tel.: +381 11 3970 127. Orari i hapjes: të hënën, të martën dhe të enjten 12.00-19.30, të mërkurën dhe të premten 9.00-16.30.

Zyra e Nishit: 18000 Niš, Učitelj Tasina 13/1., tel.: +381 18 514 130, +381 18 514 131.

Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 11.00-19.00, në ditët e tjera të punës 9.00-17.00.

Zyra e Horgoshit: 24410 Horgoš, Bartok Béla 80. tel.: +381 24 792 195. Orari i hapjes në ditët e punës: 8.00 - 16.00. Drejtori i rajonit: Branislav Rajic.

Drejtori i rajonit: Branislav Rajic.

Forever Living Products Beograd na ofron shërbimet e mëposhtme:

bërje porosish në telefon - Telecenter. Numri i telefonit: 011/309 63 82. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12: 00-19.30, të mërkurën dhe të premten 9:00-16.30. Në rastin e porositjes në telefon malli shkon tek adresa që gjendet në numrin e kodit dhe paguhet kur merret në dorë.

– Pagesa e produkteve bëhet pasi ato merren në dorë.

Vlera e transportit është 600 dinar dhe paguhet nga porositësi.

– Shpenzimet e postës duhen paguar në bazë të kursit të parasë në Serbi në ditën që ndodh marrja e mallit, dhe ato merren përsipër nga FLP-ja e Beogradit vetëm në rastin kur vlera e porositë së bërë është më e madhe se 1 pikë.

– Nuk mund të bëhet regjistrim nëpërmjet telefonit.

– Porositë telefonike merren në shqyrtim deri në datën 25 të muajit, pas kësaj date mund të porosisni vetëm personalisht në zyrën tonë.

– Edhe në zyrën e Horgosit dhe Nisit mund të blihen materiale reklamash, fletat e regjistrimit dhe formularët për ndryshimin e të dhënave.

Numrat i telefonit të specialistëve mjek:

Dr. Biserka Lazarević dhe dr. Predrag Lazarević:

+381 23 543 318

Të martën në orën 13.00-16.00 dhe të premten në orën 14.00-16.00 presin thirrjet tuaja për konsultim.

Dr. Božidar Kaurinović:

+381 21 636 9575

Të mërkurën dhe të enjten në orën 12-14 pret ethirrjet tuaja për konsultim.



MALI I ZI

Zyra e Podgoricës: 81000 Podgorica, Serdara Jola Piletića 20. tel. +382 20 245 412, tel./fax: +382 20 245 402.

Orari i punës: të hënën: 12:00 – 20:00. Në ditët e tjera të punës: 9:00 – 17:00. E shtuna e fundit e çdo muaji është ditë pune. Orari i punës: 9:00 – 14:00.

Drejtori i rajonit: Aleksandar Dakić

– Porosi produktesh mund të bëni në numrat telefonik të mëposhtëm: +382 20 245 412; +382 20 245 402.

Pagesa bëhet kur merret malli. Nëse vlera e produktit të porositur e kalon 1 pikë, shpenzimet e transportit i merr përsipër FLP-ja.

Numri i telefonit i specialistes mjek:

Dr. Laban Nevenka: +382 69 327 127



SLLOVENIA

Zyra e Ljubljanes: 1236 Trzin-Ljubljana, Borovec 3., tel.: +386 1 562 3640.

Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00, të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00.

Adresa e magazinës së Lendavait: 9220 Lendava, Kolodvorska 14.. tel.: +386 2 575 12 70, Fax: +386 2 575 12 71, e-mail: forever.living@siol.net. Orari i hapjes: të hënën 12.00-20.00, të martën dhe të premten 09.00-17.00.

Drejtori i rajonit: Kepe Andrej

Numri i Telecenterit në rastin e porosive telefonike është: +386 1 563 7501. Në rastin e porosive telefonike, mallin e dërgojmë në adresën që i përket kodit. Distributorët që duan të porosisin mall në emër të një distributori tjetër, duhet të kenë autorizim nga distributori në emrin e të cilit duan të bëjnë porosinë. Formularët e autorizimit mund të sigurohen në zyrë. Malli i porositur në telefon transportohet për dy ditë pune!

Numri i telefonit të specialistëve mjek:

Dr. Arbeiter Miran: +386 4142 0788



JUGLINDORE



KROACIA

Zyra e Zagrebit: 10000 Zagreb, Trakošćanska 16.
tel: +385 1 3909 770; Fax: +385 1 3909 771
Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten: 09.00–20.00;
të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00–17.00.

Zyra e Rijekës: 51000 Rijeka Strossmayerova 3/A.
Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten: 12.00–20.00;
të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00–17.00
tel: +385 51 372 361, +mobil: +385-91/455-1905

Drejtori i rajonit: Dr. Laszlo Molnar

– Porosi telefonike: +385 1 39 09 773,
+385 1 39 09 775.

Në rastin e porosive me vlerë më të madhe se 1 pikë krediti,
çmimi i transportit paguhet nga FLP Kroacia.

– Leksionet në lidhje me njohjen e produkteve: të hënën, të
martën dhe të mërkurën 17.00

– Nëse vlera e blerjes është më e madhe se 1500 kuna ekziston
mundësia e pagesës në dy-tre pjesë me kartën Diners Club.

Numri i telefonit të specialistëve mjek:

Dr. Ljuba Rauški Naglic,
mobil: 091 51 76 510

Në ditët teke në orarin 16.00–20.00.



SHQIPËRIA

Zyra e Tiranës: Tiranë, Reshit Collaku 36. tel/fax: +355
42230 535.

Drejtori rajonal: Attila Borbáth

Drejtori i zyrës: Xhelo Kiçaj, tel/fax: +355 694 066 811.
Kontaktim: në ditët e punës 9-13, 16-20,
e-mail: fpalbania@abcom.al



BOSNIA-HERCEGOVINA

Zyra e Bijelinës: 76300 Bijeljina, Trg D. Mihajlovića 3.,
tel: +387 55 211-784, +387 55 212-605, fax: +387 55 221 780.
Orari i hapjes në ditët e punës: 9.00-17.00.

Drejtori i rajonit: Dr. Slavko Paleksić

Zyra e Sarajevës: 71000 Sarajevo, Akita Šeremeta do br. 10., tel.:
+387 33 760 650, +387 33 470 682, fax: +387 33 760 651. Orari i
hapjes: të hënën, të enjten, të premten: 09.00–16.30, të martën, të
mërkurën: 12.00-20.00. Në çdo të shtunë të fundit të muajit (ditë
pune) organizojmë një Ditë Sukses mini në zyrën e FLP-s.

Drejtoresha e zyrës: Enra Hadžović

– Në zyrat e Bosnias porosinë telefonike mund të bëhen në
numrat e mëposhtëm (regjistrimi i shpërndarësve të rinj nuk
mund të bëhet nëpërmjet telefonit): +387 55 211 784,
Bijelinë dhe +387-33-760-650 Sarajevë.

Numri i telefonit të specialistëve mjek:

Dr. Nišić Esmā +387 62 367-545, e cila gjatë ditëve të
punës punon në orarin 18:00 – 21:00.

– Këshilltarja-specialistja jonë mjekje çdo të mërkurë mban
konsultime në zyrën e Sarajevës në orarin 17:00 – 19:30.

– Në rastin e porosisë telefonike pagesa bëhet kur merret malli.
Nëse vlera e porosisë nuk është më e madhe se 1 pikë krediti,
atëherë shpenzimet e transportit paguhet nga distributori.



KOSOVA

Pristinë Rr. Uçk br. 94, tel.: +381 38 240 781,
+377 44 503 911.



PAS RËNIES SË YJEVE *përpara shkëlqimit*

**NË DHJETOR FILLOI
ZGJEDHJA, NË MËNYRË
QË PAS NJË VITI NË SKENËN
E ARENËS SPORTIVE TË
FESTOJMË YJET E FLP-S.**



Tre konkurset eliminatorë të organizuara në qendrën e Shpk-s Forever Living Products Hungari, me të cilat u përgatitëm për në konkursin Yjet e FLP-s, na dhuruan disa ditë shumë të larmishme. U regjistruan afërsisht njëqind vetë dhe përpara jurisë dhanë shfaqje pothuajse shtatëdhjetë prej tyre. Shfaqjet u vlerësuan nga këngëtarja dhe aktorja Gabi Berkes, aktori dhe regjisori Karoly Horvath, si dhe kërcimari dhe koreografi Akos Tihanyi: duke u dhënë konkuresve maksimum 12 pikë.



Përveç jurisë aty qëndroi deri në fund edhe drejtori gjeneral Dr. Sandor Milesz i cili vuri re i habitur se sa shumë talente gjenden mes distributorëve tanë. Zbuloi nja dy konkures të cilët – pavarësisht se sipas vendimit të jurisë nuk u kualifikuan mëtej – janë të aftë që të shfaqen në Restorantin Foleja e Shqiponjave që ndodhet në qendrën e firmës të rrugës Nefelejcs. Në konkurs morri pjesë edhe grupi i FLP TV, kështu që në gjysëmfinalen e parë që do të organizohet në Ditën e Sukesit të shkurtit mund të shikojmë pjesë nga materiali i filmuar në konkurset eliminatorë. Në gjysëmfinalen dhe finalen që do të organizohet në skenën e Arenës Sportive Papp Laszlo të Budapestit juria prej tre anëtarësh do të zgjerohet edhe me dy mysafirë të tjerë, kështu që do të jenë pesë vetë që vlerësojnë shfaqjet. Edhe publiku mund të votojë nëpërmjet SMS-ve nga celulari duke shtuar me këtë numrin e pikëve të dhëna nga juria për shfaqjet.





Pamë dhe dëgjua shfaqje të mrekullueshme, dhe jam i sigurt që ato që zgjidhen nga anëtarët e jurisë për t' u shfaqur në skenën e madhe do të korrin sukses edhe në Arenën Sportive. Falenderojmë gjithë pjesëmarrësit që u paraqitën në këtë konkurs, i përgëzojmë ata dhe u urojmë përgatitje të mbarë njëzet e katër konkurseve që u kualifikuan mëtej!



Zsolt Frenko
drejtues artistik



CONQUISTADOR 2009 CLUB



LIPP SZILVIA
DHE MOLNÁR MIHÁLY



MÁTÉ KISS IMRE



VARGA JÓZSEFNÉ



WEHLINÉ MEZEI ARANKA
DHE WEHLI PÉTER



MULADI ANNAMÁRIA



VANYÁNÉ DÁNFFY BEÁTA
DHE VANYA LÁSZLÓ



BALOGH TÜNDE



JUROVIĆ ZLATKO
DHE JUROVIĆ SONJA



2009

TOP DISTRIBUTORS



HUNGARIA
MIKLÓS BERKICS



SERBIA
STEVAN LOMJANSKI DHE
VERONIKA LOMJANSKI



KROACIA
TIHOMIR STILIN
DHE MAJA STILIN



SLOVENIA
TOMISLAV BRUMEC DHE
ANDREJA BRUMEC



BOSNIA – HERCEGOVINA
VASILIJE NJEGOVANOVIĆ



FOREVER

IMRPRESSUM

Botues: Forever Living Products Hungari Shpk.

Redaksia: FLP Hungari Shpk. 1067 Budapest, Szondi u. 34. Telefon: (36-1) 269-5373 Fax: (36-1) 312-8455

Kryeredaktor: Dr. Sandor Milesz Redaktor: Attila Földi, dr. Csaba Gothárd, Valeria Kismarton, Zsuzsanna Petroczy, Kalman Posa, Sandor Rokas,

Layout, përgatitje për shtypje: Crossroad Consulting Shpk.

Koordinator projekti: Szilvia Timar Redaktor leximi: Zita Kempf Korrigjues: Ildiko Kiraly **Redaktor projekti:** Raden Hannawati

Fotograf: Robert Laszlo Bacs, Dimitrije Ostojic, Gábor Puskás, „Tomić”

Përkthim, redaktim: Dr. Marsel Nallbani (shqip), Darinka Aničić, Žarko Anić Antić (kroat), Ottilia Toth-Kasa, Balazs Molnar,

Dragana Meseldžija (serb), Jolanda Novak Csaszar, Biro 2000 Ljubljana (sloven).

Shtypshkronja: Palatia Nyomda és Kiadó Shpk. U përgatit në 39180 kopje.

Për përmbajtjen e artikujve përgjegjësia është e autorëve. Çdo e drejtë mbrohet!

www.flpseeu.com

FOREVER BUSINESS ACADEMY



PËR ÇFARË ËNDËRRON AKADEMIA TREGËTARE FOREVER?

Viti 2010 nisi me një hap me të vërtetë të madh, të denjë për vizionin e Forever-it. Krijuaam gjithë kushtet parimore dhe materiale që të sjellim në jetë edhe në Hungari Akademinë Tregëtare Forever. Mendimi i krijimit të institutit mësimor nuk është diçka e re: ai funksionon me rezultate bindëse në shumë vende të botës. Ne në Hungari jemi pionier vetëm në faktin që dëshirojmë ta ndihmojmë vullin e atyre që dëshirojnë të zhvillohen me planin përgatitor më të arritshëm (orare që përsëriten, organizime nëpër provinca...) dhe infrastrukturën më komplekse (Qendra Mësimore e rrugës Szondi në Budapest me gjithë mjetet dhe shërbimet e saj) që ekziston. Vizioni i Akademisë Tregëtare Forever është përhapja e një pikëpamje biznesi i cili kontribon shumë në rritjen e numrit të kualifikimeve. Kjo është e vërtetë sidomos në rastin e përgatitjes së tregëtarëve fillestar, apo që e fillojnë nga e para – të cilët në fazën e zhvillimit janë natyrisht akoma të lëkundur. Akademia Tregëtare Forever nisët me mision të dyfishtë. Pikësynimi i saj kryesor është t'u jap mjete efektive rrjetndërtuesve që ndodhen në nivelet më të ulta dhe t'i udhëheq që nga fillimi drejt realizimit të ëndrrave të tyre. Besojmë dhe e dimë mirë që me këtë ata shmangin shumë ndjenja disfate të cilat u heqin dëshirën atyre! Nëpërmjet kësaj Akademie Tregëtare Forever merr përsipër prej krahëve të sponsorëve shumë ngarkesa, një punë të madhe që mund t'u shkoj dëm atyre. Akademia dhe mësuesit e saj nuk konkurojnë me sponsorët! Ashtu si ndihmësit pranë piktorëve të mëdhenj, të cilët hedhin mbi pëlhurë vetëm bazat dhe linjat kryesore. Duke e ndihmuar me këtë sponsorin që me ngjyrat e shkëlqyera të përvojave dhe aftësive të tij drejtuese t'i japë dritë dhe jetë piktorës së biznesit të tij. Me bashkimin e distributorëve drejtues me Akademinë Tregëtare Forever na hapet një mundësi e shkëlqyer. Shpresa e një zhvillimi aq të vrullshëm me ndihmën e të cilit gjithë bota do të mahnitet prej nesh. Përsëri!



KONTAKTIM:

QENDRA MËSIMORE E RRUGËS SZONDI

1067 BUDAPEST, SZONDI U. 34.

+36 1 332 5956

DREJTORI I ZYRËS: ADAM PACZOLAY

AKADEMIA TREGËTARE FOREVER

PROJEKTUES: DR. CSABA GOTHARD

+36-20-207-1211

PËR TË MARRË NJOFTIME RRETH PROGRAMIT TË AKADEMISË TREGËTARE FOREVER MUND TË
REGJISTROHENI ME LETRËN E DËRGUAR NË ADRESËN E-MAIL TË MËPOSHTME: SZONDI@FLPSEEU.HU

Produktet e zgjoit të bletës



Forever Bee Honey®

Bletët e përgatisin mjaltin duke fluturuar nga lulja në lule: nektarin e pasur e ruajnë për pak kohë që ta përziejnë me enzimat e tyre dhe pastaj e çojnë mjaltin në zgjuar. Mjalti është konsideruar gjithmonë si një nga ushqimet natyrore numër një – përmban shumë lëndë ushqyese me cilësi të mirë dhe tretet lehtë.

Mjalti përmban shumë përbërës për të cilët kemi nevojë që të ruajmë shëndetin tonë. 78 % e tij përbëhet nga sheqerna (glukoz, fruktoz dhe sakaroz), si dhe përmban lëndë minerale, vitamina, enzime, proteina dhe aminoacide.

Forever Bee Honey® përmban vetëm përbërës natyror. Ky ëmbëlsues me shije të shkëlqyer dhe vlera ushqyese është plot me të mirat e natyrës, dhe një lugë gjelle prej tij përmban afërsisht 70 kalori. Tretet lehtë, është i pasur në karbohidrate, përmban shumë kalcium dhe fosfor, dhe është burim energjie i shpejtë dhe ushqyes për çdo rast.

Përbërësit: mjaltë lulesh i pastër

Masa neto: 500 g

Të dhëna shtesë	
	në 100 g produkt
Energji	1250 kcal (300 kcal)
Proteina	0 g
Yndyra	0 g
Karbohidrate	26 g
- nga këto sheqer	24 g
Natrium	0 g

Mënyra e përdorimit: mund të konsumohet në vetvete ose si ëmbëlsues natyror ushqimi.



- Shishja e ngjyrosur prej të cilës mund ta hedhim lehtë mjaltin pengon humbjen e ndonjë lëndë ushqyese me vlerë nga drita e diellit.

- Është i pasur në karbohidrate. Përmban kalcium dhe fosfor.

- Ëmbëlsues natyror, tretet lehtë.

PRODUCT #207